



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48 regjistër (JR)
Datë 26.10.2023

Nr. 20 i vendimit
Datë 12.03.2025

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më 12.03.2025, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Francesco Cardi, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, analizoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet para seancës, me të cilat ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtuar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë,¹ në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar² (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, ka hartuar Raport-kontrollin,³ në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi:*
 - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive;
 - ka mosdeklarime ndër vite;
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka hartuar një raport⁴ fillestar, i cili është përditësuar më pas, në

¹ Aktualisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

² Ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.01.2020.

⁴ Komisionit, raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit – pa përgjigjen e njërit prej organeve verifikuese/ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, për vijimin e detyrës. Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.08.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë

përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas raportit të dytë, grupi i punës ka konstatuar papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Merita Selimi.

2.3. KLP-ja ka hartuar Raportin për analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, të cilin ia ka përcjellë Komisionit⁵.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 691, datë 27.07.2023, me shumicë votash, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Merita Selimi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier [...]*.
4. Vendimi objekt shqyrtimi është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave që kanë lidhje me këtë kriter, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë pasjellë aplikimin e nenit 61, pika 3 dhe pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, mbështetur në konkluzionet si më poshtë.

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligj zbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve apo hetime të paplota, apo të pakryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

4.4. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se sjelljet e subjektit në drejtim të: **(i)** shmangies nga zbatimi i normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare në kundërshtim me etikën e magjistratit; **(ii)** problematikave mbi vërtetësinë e mjaftueshmërinë e deklarimeve të burimeve të pasurive të krijuara (apartament, obligacione e likuiditete cash), si dhe destinacionin e tyre – çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklarimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurive të saj. Këto rrethana, në

19.09.2022, të KDZH-së, grupi i punës ka ndryshuar raportin nga përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Merita Selimi.

⁵ Raporti me nr. {***} prot., datë 25.10.2021.

raport edhe me aspektet e tjera të kontrollit të kriterit pasuror, çmohen nga trupi gjykues se duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pikat 5, 4 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, për shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me ankimin, gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke pretenduar se është i pabazuar ligjërisht, si dhe vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit. Me ankimin, subjekti kërkon nga Kolegji që, në funksion të vlerësimit për cenimin e besimit të publikut, duhet të mbajë në konsideratë faktin se ajo, me vendimin e KLP-së nr. {***}, datë 02.10.2023, është marrë në mbrojtje, pasi nga të dhëna të besueshme është provuar se jeta e subjektit dhe e familjarëve të saj ka qenë në rrezik, për shkak të dhënies së vendimeve penale, që ndëshkojnë eksponentë të krimit të organizuar.
6. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): **(i)** marrjen në cilësinë e provës të akteve të bashkëlidhura ankimit; **(ii)** gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; **(iii)** ndryshimin e vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e saj në detyrë.

A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor

7. Në mënyrë të përmblodhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë:

7.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në shqyrtimin e çështjes së saj të rivlerësimit, ka kryer shkelje procedurale dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat kanë të bëjnë me: **(i)** nenin 6/1 të Konventës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së), për shkelje të parimit të sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të jurisprudencës së vetë Komisionit dhe të Kolegjit; **(ii)** cenim të parimit të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës të vendimeve në të cilat Komisioni, për situata të ngjashme me të sajat, ka bërë vlerësime të ndryshme, duke pretenduar se, për rrjedhojë, është shkelur neni 8 i respektimit të jetës private.

7.2. Vendimi është bazuar në shkaqe dhe qëndrime, për të cilat subjektit nuk i ka kaluar barra e provës me rezultatet paraprake të hetimit, duke iu mohuar në këtë mënyrë e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur.

7.3. Komisioni, asnjëherë, nuk e ka njoftuar subjektin se gjetjet e bëra prezente mund të trajtohen në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i të cilit mund të çojë në marrjen e masës disiplinore sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe cenimin e besimit të publikut

8. Në mënyrë të përmblodhur, këto shkaqe paraqiten si vijon.

8.1. Për kursimet në *cash*, të deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë, të vitit 2003, Komisioni, në mënyrë të padrejtë e të gabuar, nuk ka marrë në konsideratë si burim për krijimin e tyre:

- (i) Të ardhurat e mundshme të siguruara nga vëllezërit e subjektit, me të cilët ajo jetonte dhe kishin të njëjtën ekonomi familjare;
- (ii) Të ardhurat e siguruara në vitet 1996 – 1998, nga qiraja e objektit në Lushnjë, në pronësi të vëllezërve;
- (iii) Të ardhurat e subjektit të siguruara nga interesat bankare;
- (iv) Të ardhurat e përfituara nga këmbimi valutor nga monedha *lekë* në monedhën *dollar*, e kursimeve në *cash*, pas vitit 1991.

8.2. Për apartamentin me sip. 87.44 m,² në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, pas analizës së kryer për të verifikuar mundësinë e saj për të financuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, duke pretenduar se:

- (i) Nuk është i drejtë dhe as i bazuar ligjërisht konkluzioni se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën (-) 1.163.429 lekë, për të justifikuar depozitën bankare të krijuar në vitin 2003, e cila ka shërbyer për të realizuar pagesat e këtij apartamenti.
- (ii) Nuk është i saktë dhe as i analizuar drejt, konkluzioni se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratimet periodike të pasurisë lidhur me kursimet në *cash*, të cilat nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 3, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

8.3. Për blerjen e obligacioneve dhe llogarinë rrjedhëse në Bankën BKT, në vitin 2016, subjekti pretendon se:

- (i) Konkluzioni i Komisionit, se nuk ka deklaruar me vërtetësi burimin e krijimit të depozitës (në vitin 2012), duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, e cila ndikon edhe në analizën e burimit për krijimin e apartamentit dhe depozitës së bashku, është i gabuar dhe jo i drejtë. Subjekti, gjithashtu, pretendon se ky konkluzion i Komisionit është përtej gjetjes së njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ.
- (ii) Konkluzioni i Komisionit se, për depozitim të kryer në vitin 2012, të shumës 3.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën prej (-) 2.952.768 lekësh, e cila afekton burimin e krijimit të obligacioneve të blera në vitin 2016, është një konkluzion i gabuar, i shkaktuar për shkak të përlogaritjes në mënyrë jo të drejtë dhe jo të saktë të shtimit dhe pakësimit të kursimeve në *cash*, të evidentuara në deklaratat periodike vjetore.
- (iii) Konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes së llogarisë në Bankën BKT, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën prej (-) 2.8010.663 lekë, është një konkluzion i gabuar, i shkaktuar për shkak të përlogaritjes në mënyrë jo të drejtë dhe jo të saktë të shtimit dhe pakësimit të kursimeve në *cash*, të evidentuara në deklaratat periodike vjetore.

9. Konkluzioni për cenim të besimit të publikut, bazuar në arsyet e marrjes me të padrejtë të kredisë me kushte lehtësuese, si dhe për pasaktësitë në deklarime, nuk është i drejtë. Subjekti kërkon nga Kolegji të vlerësohet nëse veprimet e saj kanë cenuar besimin e publikut të drejtësisë, si dhe të konsiderojë në këtë drejtim edhe të dhënat e dala rishtas, që hedhin dritë për punën dhe integritetin e saj si prokurore, qëndrim i cili duket se i ka kërcënuar edhe jetën.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, që merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankueses

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar prej saj pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit kryhet në dhomë këshillimi.

Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:

- Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;
- Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNJ;
- Administrimin e provave bashkëlidhur ankimit;
- Pyetjen nga Kolegji të shtetasit T. Q. (vëllait të saj), si dëshmitar;
- Ndryshimin e vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Merita Selimi.

12.1. Gjithashtu me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa akte të reja, që ajo pretendon se lidhen me të dhëna për të cilat është informuar pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi dhe hedhin dritë mbi punën dhe integritetin e saj. Këto akte të paraqitura nga subjekti bashkëlidhur ankimit janë si vijon:

1. Vendimi i KLP-së nr. {***}, datë 02.10.2023, “Për marrjen në mbrojtje të Merita Selimit”⁶;
2. Vendimi gjyqësor nr. {***} regjistri themeltar dhe nr. {***} i vendimit, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;

⁶ Nga burime të hapura në internet, për subjektin e rivlerësimit Merita Selimi, janë publikuar këto informacione: https://shqiptarja.com/lajm/i-penduari-{***}-ju-fiksua-te-vrسته-prokuroren-e-spak-dolorezen-dhe-selimin-e-lushnjes-te-dyja-kishin-hetuar-dosjen-do-vrisnim-avokat-dogen-na-shpetoi-per-fije; https://shqiptarja.com/lajm/{***}-donte-ta-eliminonte-merret-ne-mbrojtje-ishprokurorja-e-lushnjes-merita-selimi.

3. *Vendimi gjyqësor nr. {***} regjistri themeltar dhe nr. {***} i vendimit, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;*
4. *Vendimi gjyqësor nr. {***} i regjistrimit themeltar dhe nr. {***} i vendimit, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.*

12.2. Në analizë të pretendimit të subjektit për kalimin çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, për shkak të nevojës së marrjes së provave të reja, si evidentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), evidenton se: Vendimi i KLP-së nr. {***}, datë 02.10.2023, “Për marrjen në mbrojtje të Merita Selimit”, në kuptim të përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012), konstatohet të jetë një akt, i cili ka dalë pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi dhe, për rrjedhojë, ka qenë e pamundur të paraqitej në Komision. Ky akt është paraqitur nga subjekti si një dokument që, sipas saj, duhet konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin e çështjes nëse subjekti ka cenuar ose jo besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, i cili është një ndër shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

Lidhur me nevojën e kalimit të çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, me qëllim administrimin si provë të vendimit të mësipërm të KLP-së, trupi gjykues konstatoi se marrja në mbrojtje nga strukturat përgjegjëse e subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, është një fakt i njoftuar publikisht nga mediat *online*, lehtësisht të aksesueshme nga burime të hapura. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se marrja e këtij informacioni nga burime të hapura, është një situatë që nuk passjell domosdoshmërisht nevojën e kalimit të çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, ndonëse duket se, në pikëpamje formale, ky akt plotëson kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

12.3. Trupi gjykues, lidhur me kërkimin e subjektit për administrimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, të evidentuara më sipër, bashkëlidhur ankimit, konstaton se ato janë akte/vendime⁷ që, së pari, edhe nëse do të superonin testin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në versionin që pranohet, siç pretendon subjekti se konkluzioni i Komisionit mbi cenimin e besimit të publikut nuk i është komunikuar si gjetje në rezultatet paraprake të hetimit, së dyti, konstatohet se nuk kanë të bëjnë me problematikat e shqyrtuara në Komision gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, znj. Merita Selimi.

Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për të konsideruar këto akte me cilësinë e provës së re, vlerësohet si i panevojshëm në drejtim të ndikimit që ato mund të kishin në zgjidhjen e çështjes, sipas kuptimit të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, nuk vlerësohet e drejtë marrja e tyre nëpërmjet kalimit të çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor

13. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të adresuara ndaj shkeljeve, që sipas saj kanë cenuar procesin e rregullt ligjor, të cilat u analizuan si më poshtë:

⁷ *Vendimet gjyqësore të paraqitura me ankimin nga subjekti kanë të bëjnë me vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vitin 1999 dhe në vitin 2014, tek të cilat figuron se në këto procese gjyqësore janë ngritur akuza të rënda dhe janë mbrojtur nga subjekti të rivlerësimit Merita Selimi (Qorri). Me anë të këtyre vendimeve gjyqësore është vendosur dënimi i shtetasve E. R., S. M., S. G., F. B., U. S., L. S., A. A.*

13.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni, në procesin e saj të rivlerësimit ka kryer shkelje: **(i)** të nenit 6/1 të Konventës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së), për shkelje të parimit të sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të jurisprudencës së vetë Komisionit dhe të Kolegjit; **(ii)** cenim të parimit të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës të vendimeve, në të cilat Komisioni, për situata të ngjashme me të sajat, ka bërë vlerësime të ndryshme, duke pretenduar se, për rrjedhojë, është shkelur neni 8 i respektimit të jetës private.

13.2. Po ashtu, subjekti konsideron si shkelje procedurale faktin se, sipas saj, vendimi i Komisionit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra është bazuar në shkaqe dhe qëndrime, për të cilat Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës me rezultatet paraprake të hetimit, duke iu mohuar në këtë mënyrë e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

13.3. Të dyja pretendimet e mësipërme të subjektit, rezulton se janë të adresuara në këndvështrim të qëndrimeve të mbajtura prej Komisionit, në raport me çështje konkrete të kriterit të vlerësimit të pasurisë (çështjet që kanë të bëjnë me kredinë e butë dhe përdorimin e kursimeve në cash për pagesën e këstit të parë të apartamentit). Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi t'i analizojë ato në mënyrë integrale me shkaqet e tjera të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, me qëllim shmangien e përsëritjeve dhe për kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

13.4. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ngre pretendime se Komisioni, asnjëherë, nuk e ka njoftuar se gjetjet e tij do të vlerësoheshin edhe në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili mund të çojë në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të të cilit ajo konsideron se i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim duket i pabazuar, për sa kohë është vetë përmbajtja e nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj, që kërkon një vlerësim të përgjithshëm apo tërësor sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji, si parakusht për të arritur në vlerësimin se subjekti ndodhet ose jo në situata që konsiderohen se cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë kuptim, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk është e domosdoshme dhe madje do të dukej e parakohshme që Komisioni, në rezultatet e hetimit paraprak, krahas njoftimit të gjetjeve për të cilat kalon barrën e provës, në kuptim të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, të prezantojë edhe një analizë mbi vlerësimin e përgjithshëm të situatës sipas një procesi subjektiv, vlerësim që duket se i përket analizës vendimmarrëse në përfundim të procesit, pasi është qartësuar dhe arritur në konkluzione për secilën shkelje të evidentuar.

13.5. Nga përmbajtja e raportit paraprak të hetimit rezulton se Komisioni i ka kaluar barrë prove subjektit për faktin se: duket se subjekti ka përfituar një kredi të butë jo në përputhje me kriteret e përcaktuara nga VKM-ja nr. 600, datë 12.09.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë" – rrethanë kjo që mund të bjerë ndesh me etikën e magjistratit, si edhe për pasaktësitë e deklaramentit në deklaratën vetting, që kanë të bëjnë me përfshirjen e kredisë si burim, përveç apartamentit, edhe për blerjen e obligacioneve dhe çeljen e llogarisë në Bankën BKT, në vitin 2016, të cilat janë elementet që janë vlerësuar më pas prej tij në dritën e nenit 4, pika 2 e ligjit dhe e kanë çuar në konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.

13.6. Nga sa përshkruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se, me Raportin për rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka bërë të ditura subjektit mangësitë e konstatuara, për të cilat i është

kërkuar të japë shpjegime dhe prova, në kuptim të përcaktimeve të nenit 52, pika 2, të nenit 45 dhe të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës. Në këto kushte, Komisioni ka përmbushur detyrimin e tij ligjor për t'i garantuar subjektit të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, e drejtë e cila i është garantuar asaj edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore publike.

13.7. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, lidhur me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në të cilin ajo adreson pretendime për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe të qëndrimit për kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja, trupi gjykues arriti në konkluzionin se nuk konstatohet asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do të kërkonin shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për pasojë, zhvilloi gjykimin e saj në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

14. Komisioni, në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, ka kontrolluar dhe ka konstatuar problematika në disa pasuri të deklaruar prej subjektit, në deklaratën *vetting*, konkretisht në pasuritë: **(i)** apartament me sip. 87.44 m², ndodhur në {***}, Bashkia Tiranë, në vlerën 73.687 euro; **(ii)** obligacione pranë Bankës “Credins”, në vlerën 2.000.000 lekë; **(iii)** llogari rrjedhëse pranë BKT-së Lushnjë, në vlerën 2.810.633 lekë. Pasi ka analizuar vërtetësinë e deklarimeve dhe verifikuar burimet të krijimit të këtyre pasurive, Komisioni ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, duke u vlerësuar se gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione i janë atashuar të tri pasurive të përmendura më lart, të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit të Kolegjit në përgjigje të shkaqeve të ankimit të ngritura prej subjektit të rivlerësimit.

D. Për pasurinë “Apartament banimi” me sip. 87.44 m², ndodhur në {*}, Tiranë**

15. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasurinë nr. {***} ZK {***}. Ap. sip. 87.44 m², {***}, Bashkia Tiranë, në vlerën 73.687 euro (konvertuar me lekë, 10.146.699 lekë. Pjesa takuese në bashkëpronësi me bashkëshortin, me burim krijimi: kursimet e 30 viteve punë, si dhe një pjesë të kredisë prej 5 milionë lekë. Komisioni ka marrë në analizë burimet e krijimit të kësaj pasurie, të cilat sipas deklarimit të subjektit janë kursimet në vite dhe një kredi bankare në vlerën prej 5.000.000 lekë, dhe ka arritur në konkluzionet respektive për secilën prej tyre, që janë pjesë e analizës si vijon.
16. **Lidhur me mundësinë e krijimit të kursimeve në cash, në shumën 4.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë, të vitit 2003, të analizuar në kuadër të verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë “Apartament”**

16.1. Komisioni ka verifikuar dhe kontrolluar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në DPV-2003, lidhur me kursimet në *cash* të disponuara prej saj në këtë kohë, në vlerën prej 4.000.000 lekë, në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive: *Apartament* dhe *likuiditete bankare*, të cilat janë krijuar sipas deklarimeve të subjektit duke përdorur edhe këtë gjendje likuiditeti të deklaruar që në deklaratën fillestare të pasurisë. Në vendim, lidhur me këto kursime, është arsyetuar dhe konkluduar se, në përfundim, lidhur me analizimin e burimit të ligjshëm të shumës 4.000.000 lekë cash, deklaruar në vitin 2003, trupi gjykues, për sa më sipër arsyetuar dhe

në konsideratë të vlerësimeve të kryera, çmos se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën (-) 1.155.982 lekë, për krijimin e këtyre kursimeve, të përdorura për pagesat e kësteve të blerjes së pasurisë “Apartament”, në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstatim i cili është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

16.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta konkluzionet e mësipërme të Komisionit, për mundësinë e saj për krijimin me burime të ligjshme të shumës 35.000 USD, në korrik 2003, pjesa dominante e shumës prej 4.000.000 lekë, të deklaruar si gjendje *cash*, në DPV- 2003, duke pretenduar se në krijimin e kësaj shume duheshin marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat e evidentuara më sipër në përmbajtjen e këtij shkaku ankimi. Për rrjedhojë, në funksion të analizimit të këtij shkaku, trupi gjykues mori në shqyrtim ato të ardhura, të cilat identifikohen në ankim se kanë shërbyer për krijimin e depozitës bankare në vitin 2003, por që nuk janë konsideruar si të tilla në analizën financiare të Komisionit.

16.3. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit, të cilat kundërshtonin konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e shumës prej 4.000.000 lekë, të deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën fillestare të pasurisë, në vlerën prej (-) 1.163.429 lekësh, të cilat adresoheshin kryesisht në drejtim të përfshirjes në analizën financiare të periudhës 1992 – 2003: **(i)** nga punësimi i vëllezërve të saj; **(ii)** disponimin nga subjekti për shkak të shkëmbimit valutor, në vitin 1993, të shumës 4.000 USD; **(iii)** përfitimi i interesave të përvitshme bankare mbi të ardhura e depozituara prej saj në vitet 1984 – 2003; **(iv)** përfitimi i shumës 15.000 lekë në muaj, në vitet 1996 – 1998, nga qiradhënia e lokalit të vëllait të subjektit, si edhe **(v)** të ardhurat e krijuara prej marrëdhënies së huas me shoqërinë huadhënëse “{***}” ShPK, në vlerën prej 645.000 lekë.

16.4. Subjekti pretendon se si burim krijimi i depozitës nuk janë konsideruar: *të ardhurat e mundshme të siguruara nga vëllezërit e saj, me të cilët ajo jetonte dhe kishin të njëjtën ekonomi familjare.* Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se aktet, si shkresa e ISSH-së Fier, e NRSH-së Lushnjë apo e ISSH-së Lushnjë, të cilat subjekti pretendon se provojnë punësimin e vëllait të saj, T. Q., si rrobaqepës, japin indicie nga informacioni që ofrojnë⁸, në versionin më të

⁸ Dokumentacioni i dorëzuar në Komisionin nga subjekti në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna si rrobaqepës i vëllait T. Q.:

- Vendimi nr. {***}, datë 15.06.1992, i Gjykatës së Rrethit Lushnjë, në të cilin, bazuar në dekretin nr. 7512 të vitit 1992, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, vëllai i subjektit, T. Q., është regjistruar si person fizik privat me profesion rrobaqepës.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë, për efekt pensioni, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimit Shoqëror Fier, për vëllain e subjektit, T. Q, i cili rezulton të këtë filluar punë më datë 01.10.1990, në {***} Lushnjë, si rrobaqepës. Kartela ka shënimin që mungon data e largimit nga puna.
- Vërtetim, me shkrim dore, lëshuar nga {***} Lushnjë, i cili konfirmon të ardhura të realizuara për vitin 1991 nga T. Q., në shumën totale prej 4.675 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga DRSSH Fier, për Personin Fizik, i vetëpunësuar, T. Q., për periudhën 01.06.1992 – 31.12.1993, i cili rezulton me paga për periudhën qershor – nëntor të vitit 1992 dhe për periudhën qershor – dhjetor 1993. Vërtetimi përmban shënimin që për periudhën 01.01.1994 – 30.06.2007 nuk janë derdhur kontribute. Për vitin 1992, të ardhura në shumën 5.400 lekë dhe për vitin 1993, të ardhura në shumën 10.639 lekë (shumë e cila është bërë pjesë e analizës financiare të Komisionit).

mirë, rreth punësimit të vëllait të subjektit për periudhën që ato referojnë, por nuk përcaktojnë shumat e përfituara nga ky punësim dhe as saktësojnë nisjen dhe përfundimin e këtij punësimi.

16.5. E njëjta situatë rezulton edhe për të ardhurat e pretenduara nga subjektit si të përfituara nga aktiviteti i shkëmbimit valutor të vëllezërve të saj deri në vitin 2007, për të cilat subjekti ka depozituar në Komision një tërësi aktesh⁹. Trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni konstatoi se dokumentacioni i disponuar në fashikullin e hetimit administrativ, i paraqitur nga subjekti provon ligjshmërinë e kryerjes së këtij aktiviteti prej vëllezërve të saj nga viti 2007 e në vijim, por jo para kësaj periudhe, në të cilën ky aktivitet kryhej në mënyrë informale. Në kushtet kur aktiviteti i pretenduar si i ushtruar nga vëllezërit e subjektit, përpara vitit 2007, nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor, duke konsideruar gjithashtu qëndrimin që Kolegji ka mbajtur për vlerën provuese të deklaratave noteriale kur ato nuk mbështeten nga dokumente të kohës apo të dhëna të tjera të provueshme, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni çmon se përfitimi i të ardhurave nga aktiviteti i shkëmbimit valutor të vëllezërve të subjektit, për periudhën e marrë në analizë, 1992 – 2003, nuk provohet. Për më tepër, nga informacioni që japin deklaratat noteriale të paraqitura për këtë qëllim nga subjekti, dhe në rast se konsiderohen me vlerë të plotë provuese, ato në versionin më të mirë provojnë kryerjen e aktivitetit në fushën e këmbimit valutor para vitit 2007, por sërish nuk provojnë sasinë e të ardhurave vjetore të siguruar prej këtij aktiviteti dhe as ligjshmërinë e tyre, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që këto të ardhura të përfshiheshin në analizën financiare për periudhën objekt kontrolli.

16.6. Lidhur me pretendimin e subjektit se, deri në vitin 1993¹⁰, ka disponuar shumën 4.000 USD, të cilën e ka siguruar si përfitim nga shkëmbimi valutor (nga monedha lekë në monedhën dollar amerikan) i kursimeve të saj të deriatëhershme, trupi gjykues konstaton se disponimi i kësaj shume ka mbetur i paprovuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, pasi nuk ka mundur të paraqesë akte të kohës kur pretendon që është realizuar ky këmbim. Vetëm provueshmëria hipotetike e pasjes së shumës në lekë, të krijuar si kursim në këto vite, nuk mjafton për të krijuar bindjen se ajo është këmbyer ekzaktësisht në vlerën e 4000 USD, në atë kohë, ndonëse në analizë të të dhënave të

• Vërtetim nr. {***}, datë 04.02.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, i cili konfirmon se për shtetasin T. Q. nuk disponohen të dhëna si tatimpagues pranë DRT-së Fier, për vitin 1992, me aktivitet “Rrobaqepësi”.

• Mandatarkëtimi nr. {***}, datë 16.12.1992, mbi pagesën e sigurimeve shoqërore për 6-mujorin e dytë të vitit 1992.

• Akt-shpenzimi për dorëzimin e objektit “Rrobaqepësi”, i shitur nga Agjencia e Privatizimit Lushnjë, 3 blerësve, ndër të cilët dhe T. Q.

• Kontratë shitje, e datës 8 shtator 1992, për shitjen e objektit “Rrobaqepësi”, nga Agjencia e Privatizimit Lushnjë, dhënë 3 blerësve, ndër të cilët dhe T. Q.

⁹ Dokumentacioni i disponuar në Komisionin në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti i këmbimit valutor të vëllezërve të saj:

• Shkresë nr. {***}, datë 14.07.2023, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, Dega Lushnjë, e cila informon se për veprimet e kryera (këmbime valutore) në arkën e ish-Bankës së Kursimeve, për periudhën 1991 – 2003, sipas rregullores së arkivimit, dokumentacioni i kësaj kategorie ka një afat ruajtje prej 10 vitesh. Mbas kalimit të këtij afati, dokumentet asgjësohen dhe, në të tilla kushte, jemi në pamundësi për t’ju vënë në dispozicion të dhënat e kërkuara.

• Një mandat tërheqjeje të vitit 1998 nga BKT-ja, Dega Lushnjë, të shumës 7.5 milionë dhrahmi greke (~ 3 milionë lekë), e cila ka qenë e depozituar në një depozitë pa afat, në emër të Q. Q.

• Tri deklaratat noteriale të shtetasve të ndryshëm, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.07.2023, që kanë deklaruar se kanë ushtruar aktivitetin e këmbimit valutor së bashku me vëllezërit e subjektit, edhe përpara vitit 2007.

• Certifikatë e regjistrimit të personit të tatueshëm “{***}”, me nr. Nipti {***}, regjistruar më datë 20.06.2007 dhe Licencë me nr. {***}, datë 17.07.2007, për zyrën e këmbimit valutor “{***}” ShPK, Lushnjë.

¹⁰ Subjekti referon se kursi i këmbimit valutor në vitet 1991–1992 ka qenë 1 USD = 7 ose 8 lekë.

kursit të këmbimit, në periudhën në fjalë, mund të sugjerohet krijimi i kësaj vlere në monedhë të huaj. Në këto kushte, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, vlerëson se pretendimi i subjektit për disponimin e kësaj vlere mbeti në nivel deklarativ. Për pasojë, kjo vlerë nuk u përfshi as në analizën financiare të kryer në Kolegj, në funksion të kontrollit të analizës së kryer nga Komisioni.

16.7. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit lidhur *me interesat e përfituara nga depozitat bankare*, gjatë periudhës 1984 – 2003¹¹, të cilat ajo pretendon se duhet gjithashtu të përfshihen në analizën financiare të kësaj periudhe.

16.8. Komisioni i ka konsideruar të paprovuara me dokumentacion justifikues këto pretendime të subjektit. Ky qëndrim i Komisionit është bazuar në konfirmimet e “Raiffeisen Bank”, referuar verifikimeve të kryera në arkivin e Bankës së Kursimeve, Dega Lushnjë, nga i cili ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një depozitë kursimi, e cila në datën 31.12.1995 ka qenë në vlerën 4.709 lekë, shifër kjo e konsideruar si papërfillshme në raport me pretendimet e subjektit, për të ardhurat nga interesat e depozitave bankare.

Në ankim, ashtu siç edhe ka pretenduar në Komision, subjekti shprehet se interesat bankare gjatë këtyre viteve kanë pasur norma të larta dhe sidomos në vitin 1997, ato kanë qenë rreth 27.8%. Në mbështetje të këtij pretendimi, për periudhën 1984 – 2003, subjekti ka paraqitur në mënyrë tabelore përllogaritjen e bërë prej saj të interesave, duke përdorur të dhënat mbi % e interesave të marra nga *website* i Bankës së Shqipërisë. Ndërsa, për të identifikuar shumat e përfshira në depozita bankare mbi të cilat duhet të përllogariteshin interesat e mësipërm, subjekti ka paraqitur në Komision një vlerësim të bërë po prej saj, që bazohet në informacionin që japin borderotë e pagave të atëhershme të subjektit, në të cilat identifikohen qartë kursimet e derdhura drejtpërdrejt nga punëdhënësi në llogarinë e kursimit të subjektit, në masën rreth 70% të pagës neto mujore. Sipas kësaj metodologjie, subjekti pretendon se shumata e kursimeve dhe e interesave të përllogaritura prej saj në këtë periudhë, shkojnë në vlerën prej 6.597.561 lekë.

16.9. Sipas subjektit, e dhëna që ka rezultuar nga korrespondenca e Komisionit me Bankën “Raiffeisen”, nëpërmjet së cilës është konfirmuar se subjekti, në datën 31.12.1995, ka disponuar një depozitë kursimi me vetëm 4.709 lekë, nuk është e saktë, për shkak se banka nuk ka dërguar në Komision informacion të plotë. Kursimi dhe vendosja e të ardhurave të kursyera në depozitë ka qenë një mënyrë sjelljeje e subjektit e provuar nga një sërë provash dokumentare gjatë hetimit, siç janë borderotë e viteve 1986 dhe 1991. Në këtë kontekst, subjekti pretendon se shumata e kursyera dhe interesat e përllogaritura nëpërmjet metodologjisë së mësipërme, duhet të ishin vlerësuar nga

¹¹ Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në Komisionin në lidhje me të ardhurat nga interesat bankare:

- Shkresa nr. {***}, datë 14.12.2022, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dhëna mbi shumata të investuara nga subjekti i rivlerësimit, interesa të fituara apo shumata të tërhequra nga subjekti i rivlerësimit në Bankën e Kursimeve, dega Lushnjë, e cila, pas verifikimit të kryer në arkivin e ish-Bankës së Kursimeve, Dega Lushnjë, ka bërë me dije se në emër të znj. Merita Selimi (Qorri) ka pasur një depozitë kursimi me nr. {***} dhe se gjendja e kësaj depozite, në datën 31.12.1995, ka qenë në masën 4.709 lekë – duke shtuar se nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me datën e hapjes së depozitës, shumës me të cilën është hapur apo lëvizjet e kryera në të.
- Shkresa e datës 21.03.2016, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, Dega Lushnjë, e cila ka bërë me dije se znj. Merita Qorri figuron të ketë qenë depozituese në Bankën e Kursimeve Lushnjë, vërtetuar nga libri i depozituesve me nr. kartele {***}, depozitë kjo e mbyllur në datën 17.10.1996 (sjellë me Pyetësin nr. 2).
- Vërtetim nr. {***}, datë 20.01.2017, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, bashkëlidhur se cilës gjendet tabela me të dhëna mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti ndër vite, ku në të cilat evidentohen dhe ndalesat e kryera nga institucioni për transferim të Libreza e kursimit.

Komisioni minimalisht në zbatim të parimit të proporcionalitetit për diferencën negative të konstatuar prej tij.

16.10. Trupi gjykues, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të përfituara në periudhën 1985 – 2003 nga interesat e përfituara nga depozita, ndonëse konstaton se arsyetimi dhe përlllogaritja e bërë nga subjekti rreth shumave të depozituara nga pagat, të cilat përfaqësojnë rreth 70% të tyre (mbështetur kjo në borderotë e kohës, në të cilat evidentohen reduktimet e drejtpërdrejta nga paga për transferim në llogari kursimi) si dhe aplikimi mbi to i interesave të kohës, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, është një përlllogaritje¹² e arsyeshme për situatën konkrete të subjektit të rivlerësimit, sërish sjell në pah se ajo nuk mbështet me dokumentacion justifikues, i lëshuar nga bankat që kanë operuar në periudhën e pretenduar nga subjekti, gjatë së cilës janë përfituar interesat bankare. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideroi të drejtë mospërfshirjen në analizë financiare të vlerës së identifikuar nga subjekti si shuma e përfituar nga depozitat bankare dhe interesat deri në vitin 2003. Nisur nga të dhënat që dëshmojnë dokumentet bankare të kësaj kohe, se subjekti ka përfshirë në depozitë bankare si kursime të ardhurat nga paga në masën 70% të saj, trupi gjykues e konsideroi këtë rrethanë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

16.11. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se, edhe përfitimi i shumës prej 15.000 lekë/muaj, në vitet 1996 – 1998, e pretenduar nga subjekti si e siguruar nga qiraja pas vitit 1996 për objektin/lokalin e vëllait, në Lushnje, ka mbetur në nivel deklarativ, në kushtet kur prej subjektit gjatë hetimit administrativ në përgjigje të barrës së provës, nuk është paraqitur asnjë kontratë qiradhënieje apo ndonjë akt tjetër i kohës, që provon përfitimin e qirasë nga familja e saj e origjinës për këtë periudhë.

16.12. Gjithashtu, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se, deri në fund të vitit 2003, familja e saj e origjinës ka përfituar të ardhura nga huadhënia e shumave monetare në shoqëritë huamarrëse (në këtë rast shoqëria “{***}” ShPK), në vlerën prej 645.000 lekë. Për të provuar këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision shkresën me nr. {***} prot., datë 07.02.2022, të lëshuar nga Ministria e Financave, struktura e vartësisë “Shoqëritë Huamarrëse në Administrim”, në të cilën evidentohet se familjarët e subjektit kanë përfituar në formën e interesit, deri në korrik të vitit 1996, në total shumën 145.000 lekë, për vlerën monetare prej 500.000 lekësh, e dhënë /huazuar në shoqërinë “{***}” ShPK. Në këtë situatë, duke iu referuar analizës së bërë më parë prej Kolegjit¹³ për një rast të ngjashëm, trupi gjykues e konsideroi të drejtë pjesërisht këtë pretendim të subjektit, vetëm për sa i përket të ardhurës së shumës 145.000 lekë, si vlerë e interesit të shumës së huazuar, jo vetëm për shkak se përfitimi i kësaj vlere, në kohën kur pretendon subjekti, konfirmohet nga organet shtetërore, por edhe sepse për familjarët e saj rezultojnë indicie nga të dhënat që vijnë nga organet shtetërore për kryerjen e veprimtarive private, të cilat duket se kanë prodhuar të ardhura, ndonëse jo të matshme për efekt të analizës financiare.

16.13. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, trupi gjykues konstatoi se, edhe pas këtij korrektimi, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së saj të origjinës mbetet me mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash*, të deklaruar në vitin 2003, në masën (-)

¹² Përlllogaritja e interesave sipas tabelës në poshtëshënimin nr. 9, e cila shkon në vlerën rreth 3.920.000 lekë.

¹³ Shih vendimin e Kolegjit nr. 15/2021(JR), paragrafi 21.30, faqe 17.

https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi_Kastriot_Selita_web-2.pdf

1.007.790 lekë, duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Kursimet në *cash*, deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë në vite dhe të përdorura për pagimin e kësteve të pasurisë “Apartament”

17.1. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këto burime, në raport me konkluzionet e Komisionit, se ajo gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagimin e kësteve të financimit të këtij apartamenti, mbështetur kryesisht në qëndrimin se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratat periodike pakësimin e kursimeve/gjendjes *cash* si burim për krijimin e kësaj pasurie, qëndrim i cili kishte pasjellë moskonsiderimin e kursimeve në *cash* si burime për financimin e tij dhe balancën negative respektive.

17.2. Komisioni ka analizuar në vendim deklarimet e subjektit për krijimin dhe përdorimin e kursimeve në *cash*, si burim për krijimin e pasurive të saj *Apartament* dhe *Likuiditet* në sistemin bankar. Pas analizës që Komisioni i ka bërë deklarimeve në vite të subjektit lidhur me to, ka arritur në përfundimin se ato kanë qenë të pasakta dhe e kanë bërë të pamundur/vështirë, vlerësimin e tyre në drejtim të përfshirjes në analizën financiare të kryer për verifikimin e mundësisë së subjektit për krijimin e pasurive të saj. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratat periodike vjetore lidhur me kursimet në *cash*, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

17.3. Subjekti ka kundërshtuar këtë qëndrim të Komisionit, i cili në vlerësimin e trupit gjykues, nuk rezulton të jetë ngritur në nivelin e një shkaku shkarkimi për kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar konkluzionit përfundimtar të vendimit, por është trajtuar në kuadër të vlerësimit tërësor që Komisioni ka bërë në përfundim të procesit të rivlerësimit, duke u konsideruar, së bashku me problematikat për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese, se e vendosin subjektin në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17.4. Në këto rrethana, trupi gjykues lidhur me këtë konkluzion, të analizuar në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, vlerëson vetëm të sjellë në pah qëndrimet e jurisprudencës së tij, tashmë të konsoliduar se, edhe në versionin që pasaktësitë në deklarimet periodike qëndrojnë, ato nuk mund të kualifikohen *a contrario*, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit, kualifikim i cili mund t’i asociohet vetëm pasaktësive të konstatuara në deklaratën *vetting*. Në këtë mënyrë e gjen të pambështetur në ligj këtë konkluzion të Komisionit. Trupi gjykues i analizoi deklarimet e subjektit nëpër deklaratat periodike vjetore, në funksion të verifikimit dhe kontrollit të burimeve për krijimin e pasurisë të subjektit, si edhe vlerësoi peshën e tyre në kuadër të nenit 61, pika 5 e ligjit, në vijim të këtij arsyetimi, në pjesën kur analizohet konkluzioni për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

17.5. Komisioni ka verifikuar deklarimet e subjektit, se kursimet në *cash* janë përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit dhe, pasi ka vlerësuar deklarimet e saj në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike, në mungesë të deklarimit të shprehur për pakësimin e gjendjes *cash*, ka konkluduar se: *Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë e qartë në deklarimin e gjendjes cash lidhur me shtesat, pakësimet apo saktësimin e përdorimit të kësaj gjendjeje se për cilën pasuri është përdorur ky cash i krijuar, nuk krijon bindjen se subjekti është e sinqertë në deklarimin e kësaj*

gjendjeje [...]; duke mos marrë në konsideratë përdorimin e këtyre kursimeve në cash, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar kryerjen e pagesës prej 22.000 euro, e konvertuar kjo në 3.053.820 lekë. Ky qëndrim i Komisionit rezultoi në jetë i ndryshëm dhe në tejkalim të konkluzioneve të njoftuara subjektit me rezultatet e hetimit paraprak, në të cilat duket se Komisioni e ka konsideruar të superuar problematikën e mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes cash dhe ka besuar subjektin në përdorimin e kësaj gjendjeje për pagesën e kështit të parë, duke njoftuar një rezultat pozitiv lidhur me këtë burim¹⁴.

17.6. Në analizë të pretendimeve të subjektit në ankim, lidhur me konkluzionin e mësipërm të Komisionit, konstatohet se argumenti i përdorur nga Komisioni për moskonsiderimin e kursimeve në cash të subjektit, si burim për pagimin e kështit të parë të apartamentit, lidhet vetëm me mungesën e deklarimit në deklaratat periodike të përdorimit të kursimeve në cash për pagesën e kësteve të kësaj pasurie, dhe jo me mungesën e burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj gjendjeje. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se analiza e tij duhet të ndalej në dy momente: **(i)** nëse deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratat periodike lejojnë përdorimin e kursimeve në cash si burim financimi për pagesën e kësteve¹⁵ të apartamentit në Tiranë, në vitin 2010 dhe 2011, si dhe **(ii)** në mundësinë e subjektit për t'i krijuar këto kursime me burime të ligjshme.

17.7. Në funksion të kryerjes së kësaj analize, trupi gjykues shqyrtoi deklaratimet e bëra nga subjekti për burimet e financimit të kështit të parë¹⁶ të apartamentit në Tiranë dhe kursimet në cash, në deklaratën vetting, në deklarimet periodike të pasurive, si dhe në ILDKPKI, nga të cilat rezultuan deklarimet si vijon:

i. Në deklaratën vetting: *Pasuria nr. {***}ZK{***}, apartamenti me sip. 87.44 m² në {***}, Tiranë, në vlerën 73.687 euro. Kjo pasuri është blerë me kursimet 30 vjet punë, si dhe një pjesë të kredisë 5 (pesë) milionë lekë. Pjesa takuese në bashkëpronësi me bashkëshortin.*

ii. Në DPV-2010: *Apartament banimi 2+1 {***}, Tiranë (kontratë parablerje shitje, datë 17.12.2010), Burimi – kursimet 22 vjet punë, si dhe një pjesë 5 milionë kredi bankare në BKT, me 4 % interes, e palëvruar. Vlera: 73.687 euro (paguar 20.000 euro, kësti i parë).*

iii. Në ILDKPKI, mars 2016, lidhur me pagesën e kështit të parë të apartamentit, subjekti ka deklaruar: *[...] në dhjetor të vitit 2010, gjendja cash është pakësuar me 3.000.000 lekë (22.000 euro), për arsye të pagesës së kaparit për blerjen e apartamentit në dt. 17.12.2010, pra në fund të vitit 2010 kemi pasur gjendje në banesë shumë 4.160.000 lekë. Në vitin 2011, në datën 25.02.2011, është paguar kësti i parë në vlerën 2.117.300 lekë, për blerjen e apartamentit, pra pas pagesës së kështit, kam pasur në banesë shumë prej 2.042.700 lekësh, ndërkohë për vitin 2011 kam shtuar nga kursimet shumë 600.000 lekë.*

17.8. Në analizë të deklarimeve të mësipërme rezultoi, *së pari*, se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën vetting si një nga burimet e krijimit të pasurisë “Apartament”, kursime të saj të 30 viteve

¹⁴ Në rezultatet e hetimit lidhur me kështin e parë të apartamentit, trupi gjykues i Komisionit shpreh se: *Duke konsideruar përdorimin e këtyre kursimeve - të përmendura si burim financiar i përdorur për kryerjen e pagesës (kursimet e 22 viteve punë), ndonëse të padëklaruara si të pakësuar në masën përkatëse, por të pohuara pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 21.03.2016 - ato duket se kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar kryerjen e pagesës prej 22.000 euro, e konvertuar kjo në 3.053.820 lekë.*

¹⁵ Analiza e Komisionit është e njëjtë lidhur me pagimin e kështit të dytë, me burim kursimet në muajin shkurt të vitit 2011.

¹⁶ Si dhe të kështit të dytë.

punë, duke ekspozuar ndaj kontrollit të organeve të rivlerësimit pikërisht këtë burim për krijimin e kësaj pasurie. Në funksion të kontrollit të vërtetësisë së këtyre deklaratimeve të bëra në deklaratën *vetting*, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sugjeron përdorimin si provë të deklaratave periodike të pasurisë, të cilat, veçanërisht në drejtim të përcaktimeve që lidhen me gjendjen e *cash-it*, janë vlerësuar prej jurisprudencës së Kolegjit se kanë një vlerë të posaçme provuese si një pasuri, e cila nuk mund të rezultojë e pasqyruar në akte të tjera. Nën këtë optikë, trupi gjykues vlerësoi deklaratimet e mëparshme të subjektit, nga analiza e të cilave rezultoi i konfirmuar ky burim, sipas deklaratimeve në deklaratën *vetting*. Për të arritur në këtë konkluzion, konsideruan rrethanat e mëposhtme.

17.9. Nga të dhënat e rezultuara lidhur me këtë moment evidentohen si me vlerë provuese ato që gjenerohen si vijon: **(i)** në DPV-2010, rezulton se subjekti ka deklaruar si burim financimi të pagesës së këstit të parë të apartamentit *kursimet e 22 viteve pune*; **(ii)** subjekti në mënyrë të përvitshme, në periudhën 2003 – 2010 ka deklaruar kursime në *cash*, në banesë, të cilat, si nga analiza financiare e kryer në Komision, ashtu dhe në Kolegj, kanë rezultuar se ishin krijuar me burime të ligjshme; **(iii)** nga deklaratimet periodike të subjektit dhe të bashkëshortit rezultojnë se ata si burim të ardhurash kanë vetëm ato të siguruar nga punësimi, të cilat janë kursyer vit pas viti; **(iv)** llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortit, në vitin 2010 dhe 2011, nuk janë tërhequr, që do të thotë se kursimet e cituara në deklaratën *vetting* i përkasin kursimeve në *cash*; **(v)** shpjegimet e dhëna në ILDKPKI¹⁷ nga subjekti, në mars të vitit 2016, të cilat datojnë në kohë përpara miratimit të ndryshimeve kushtetuese¹⁸, me të cilat u miratua nisja e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në të cilat subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar përdorimin e kursimeve në *cash*, për pagesën e kësteve të apartamentit, duke i identifikuar si kursime të 22 viteve pune, që në këndvështrim të jurisprudencën së Kolegjit janë me vlerë provuese, në rast të harmonizimit të tyre me të dhëna nga burimet e tjera dhe në varësi të kohës së dhënies së tyre, si në rastin konkret.

17.10. Në referim të sa më sipër, për sa kohë në DPV-2010, subjekti ka përcaktuar si burim të pagesës së këstit të parë të apartamentit, në Tiranë, *kursimet 22-vjeçare nga puna* dhe e ka mbështetur këtë deklaram edhe në akte tjera, por edhe në indicie të përmendura më lart, trupi gjykues vlerëson se gjenden mjaftueshëm gjurmë dokumentare të kohës, që konfirmojnë përdorimin e kursimeve si një burim për pagesat e apartamentit. Gjithashtu, meqë u konstatua se llogaritë e saj bankare nuk kanë pësuar ndryshime, konfirmohet deklarimi i subjektit, se termi *kursim* do të kuptojë kursimin në *cash* të deklaruar në vite. Fakti që subjekti ka munguar të shprehet për pakësim të kursimeve, si edhe vlerën

¹⁷ Në procesverbalin e mbajtur më datë 21.03.2016, në ILDKPKI, subjekti është pyetur (pyetja nr. 3-b) se çfarë ka ndodhur me *cash-in* e disponuar prej saj, të deklaruar në DPV/2003, në shumën prej 4.000.000 lekësh. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se, pas tërheqjes së këtyre shumave nga depozitat pranë BKT-së, këto shuma kanë qenë gjendje *cash* në banesë deri në momentin e blerjes së apartamentit, në vitin 2010.

Gjithashtu, subjektit në pyetjen nr. 4, i është kërkuar të sqarojë gjendjen e *cash-it* vit pas viti, si dhe sa ka qenë gjendja e *cash-it* në datën 31.12.2014, për të cilat ka shpjeguar si vijon:

Për sa i përket gjendjes së *cash-it*, shpjegoj se shumat prej vitit 2003, që nis me shumën 4.000.000 lekë, të cilën unë e kam deklaruar dhe e kam pasur gjendje në bankë, në vitin 2004, këtë shumë e kam tërhequr dhe, ashtu siç shpjegova edhe më lart, e kam pasur gjendje në banesë.

Në vitin 2005 kam deklaruar gjendje *cash* 200.000 lekë dhe i jam referuar kursimeve të vitit 2005, pra shuma totale e gjendjes *cash* ka qenë 4.200.000 lekë. Me këtë logjikë kam ecur dhe për vitet në vijim.

Në vitin 2006 kam pasur 4.700.000 lekë.

Për vitin 2008, shumën 5.600.000 lekë.

Për vitin 2009, dua të saktësoj se me deklarimin “Shtesë 350 mijë lekë”, kam pasur parasysh shumën 186.888 lekë të b/shortit në llogarinë rrjedhëse të pagës, plus 160.000 lekë *cash* në banesë, të cilën nuk e kam saktësuar si *cash*, pra shuma totale në vitin 2009 ka qenë 610.000 lekë. Pra, për vitin 2009 kemi pasur gjendje totale 6.210.000 lekë.

¹⁸ Të miratuara me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016.

e saktë të pakësuar, ndonëse konsiston në deklaram jo të plotë në deklaratën periodike përkatëse, nuk mund të pengojë trupin gjykues nga një lexim harmonik dhe i logjikshëm i deklarameve të marra në analizë, i cili përfaqëson një prej detyrave dhe tagrave të organeve të rivlerësimit në këtë proces.

17.11. Në të njëjtën linjë logjike, trupi gjykues mori në analizë edhe deklarimet për përdorimin e kursimeve ndër viteve, për pagesën e kryer nga subjekti, për një pjesë të kështit të dytë të apartamentit, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, të paguar sipas dokumentacionit bankar të BKT-së, të datës 25.02.2011, në vlerën 2.117.300 lekë. Duke abstraguuar në këtë moment të arsytimit nga kronologjia e kryerjes dhe e finalizimit të kësaj pagese, e cila do të trajtohet në vijim të këtij arsytimi, krahas marrëdhënies së huas së përkohshme që subjekti ka pasur me vëllezërit e saj, trupi gjykues vlerëson të konfirmojë të njëjtin qëndrim lidhur me faktin që, edhe për këtë pagesë, nga leximi që i bëhet deklaramave periodike të vitit 2010 dhe 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur kursimet e akumuluar në vite. Lidhur me këtë moment evidentohet se subjekti në deklaratën periodike të vitit 2010, të depozituar në ILDKPKI, në mars të vitit 2011, ka deklaruar se burimet e krijimit të pasurisë “Apartament” janë ato të 22 viteve punë dhe kredia bankare e palëvruar ende. Krahas këtij deklarimi, në të njëjtën rubrikë, subjekti ka deklaruar se është paguar në vitin 2010 shuma prej 22.000 euro¹⁹, duke nënkuptuar se diferenca nga kursimet dhe kredia nuk janë paguar efektivisht në këtë vit. Në të njëjtën linjë logjike vjen edhe deklarimi i subjektit në DPV-në e vitit 2011, në të cilën, në rubrikën e ndryshimeve të interesave privatë, subjekti deklaroi: *kontratë hipoteke nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 26.02.2011, lëvruar kredia 5 milionë lekë në 05.08.2011. Paguar 53.687 euro, nga këto 5 milionë lekë kredi, duke nënkuptuar që diferenca prej 2.117.300 lekësh²⁰ është paguar prej kursimeve, burim i cili është deklaruar në DPV-2010, si i vetmi krahas kredisë.*

17.12. Këto deklarime të subjektit u vlerësuan edhe në harmoni me deklarimet e saj në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 21.03.2010, në të cilin lidhur me këtë pagesë, subjekti ka shpjeguar: *[...] në fund të vitit 2010 kemi pasur gjendje në banesë shumë 4.160.000 lekë. Në vitin 2011, në datën 25.02.2011, është paguar kështi i parë, në vlerën 2.117.300 lekë, për blerjen e apartamentit, pra pas pagesës së kështit, kam pasur në banesë shumë prej 2.042.700 lekësh [...].* Këto shpjegime të dhëna për organin kontrollues, jo vetëm që janë në harmoni me deklarimet që ajo ka bërë në deklaramat periodike, ndonëse jo në mënyrë të plotë, por edhe i plotësojnë ato dhe karakterizohen nga një koherencë dhe logjikë në deklarime, që krijojnë bindjen për vërtetësinë e tyre.

17.13. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se edhe kjo pagesë në shërbim të shlyerjeve të kësteve të apartamentit është kryer duke përdorur kursimet e subjektit të etiketuara si të 22 viteve punë.

17.14. Në përfundim, trupi gjykues, pas një leximi të kujdesshëm të deklarimeve në deklaratën vetting, në të cilën subjekti deklaroi se burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer kursimet e

¹⁹ Në DPV-2010, subjekti ka deklaruar: paguar shuma 20.000 euro. Në kontratën paraprake noteriale me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., të datës 17.12.2010, pala shitëse, “{***}” ShPK dhe pala blerëse, Merita dhe A. Selimi, në nenin e emërtuar “Vlera e Shitjes” përcaktojnë se: “Kështi i parë, në shumë 22.000 euro, është likuiduar nga pala blerëse në favor të palës shitëse jashtë kësaj zyre noteriale dhe se kështi i dytë, në shumë 51.687 euro, do të likuidohet në momentin që pala blerëse do të përfitojë një kredi bankare te BKT Tiranë”. Në përgjigje të pyetjes nr. 10, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 21.03.2016, subjekti ka shpjeguar që, në plotësimin deklaramës, ka pasur një lapsus për sa i përket pagesës së kështit të parë. Shuma ka qenë 22.000 euro dhe pagesa e kështit të dytë, të cilën e kam deklaruar 53.000 euro, ka qenë 51.000 euro.

²⁰ Vlera 2.117.300 lekësh identifikohet si diferenca midis vlerës 7.117.300 lekë (ekuivalente me 51.689 euro), e cila përfaqëson vlerën e mbetur të papaguar të apartamentit pas pagesës së kështit të parë, në dhjetor 2010, me vlerën 5.000.000 lekë, që është kredia e butë e siguruar nga subjekti në zbatim të VKM-së 600/2007.

30 viteve punë dhe kredia bankare, harmonizuar me deklaratimet e kryera në deklaratën periodike të vitit 2010, vit në të cilin është krijuar pasuria, se *burimi i krijimit të saj janë kursimet dhe një kredi ende e palëvruar*, si edhe në raport me shpjegimet/sqarimet e dhëna nga subjekti në procesverbalin datë 21.03.2016, në ILDKPKI, i cili mbështet dhe shtjellon më tej këto deklaratime, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, lidhur me mospërdorimin e gjendjes *cash* si burim krijimi i pasurisë, është i pasaktë dhe nuk vjen si rrjedhojë e një analize logjike e sistematike të të gjitha të dhënave. Vetëm mospërdorimi i termit *pakësim*, në deklaratën periodike të pasurisë, ndërsa është deklaruar qartë se kursimet janë një nga burimet e krijimit të pasurisë, vlerësohet nga trupi gjykues si jo objektiv e në tejkalim të standardeve orientuese për leximin/interpretimin e deklaratimeve në deklaratat periodike.

17.15. Në këtë kontekst, duke konstatuar se subjekti ka deklaruar përdorimin e kursimeve për krijimin e pasurisë “Apartament”, në deklaratën periodike vjetore 2010, që mbështet deklarimin e bërë edhe në deklaratën *vetting*, trupi gjykues vlerëson se veprimi vijues i detyrueshëm është kontrollimi i burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së deklaruar si gjendje *cash*, dhe nëse ajo justifikonte krijimin e pasurisë.

17.16. Trupi gjykues, në vijim kreu verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme kursimet në *cash* të përdorura për pagesën e apartamentit në Tiranë, respektivisht të kështit të parë, në dhjetor të vitit 2010 dhe të një pjese të kështit të dytë, në shkurt të vitit 2011, për sa i përket vlerës shtesë mbi shumën e përfutur nga kredia me kushte lehtësuese, nga Banka BKT.

17.17. Në referim të sa analizuar më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolli analizën financiare të kryer prej Komisionit, në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumat e përdorura, prej kursimeve në *cash* në vite, për pagesat e kështit të parë dhe pjesërisht të kështit të dytë të apartamentit në Tiranë, duke reflektuar në të konkluzionet e mësipërme se: **(i)** nga analizimi harmonik dhe jo në mënyrë të veçantë i deklaratimeve të bëra në deklaratën *vetting*, në deklaratimet periodike të pasurisë, si dhe në ILDKPKI, pranohet përdorimi i kursimeve në *cash* si burim financimi i apartamentit në Tiranë; **(ii)** në ndryshim nga analiza financiare e Komisionit, në Kolegj rezultoi se, në fund të vitit 2003, subjekti dhe familja e saj e origjinës kishin mungesë burimesh të ligjshme shumën (-) 1.007.790 lekë, për të krijuar shumën prej 4.000.000 lekë; **(iii)** subjekti, ashtu siç ka konkluduar edhe Komisioni, kishte burime të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruara në vitet 2005 – 2011; **(iv)** nga analiza e kryer në terma matematikorë për shumat e kursimeve të përdorura për pagesën e kësteve, rezultoi se pas pagesës së kështit të parë, në vlerën 22.000 euro, gjendja e *cash*-it të disponuar nga subjekti në fund të vitit 2010 ishte në vlerën 4.000.000 lekë, nga e cila gjeneroi vlera pjesore e kështit të dytë, prej 2.117.300 lekësh.

17.18. Mbështetur në këto të dhëna, Njësia e Shërbimit Ligjor verifikoi, nëpërmjet korrektimit të analizës financiare të Komisionit, mundësinë e subjektit për pasjen ose jo të burimeve të ligjshme për financimin e dy shumave të përcaktuara më lart, të cilat kanë si burim kursimet e subjektit në vite. Nga kjo analizë, duke e korrigjuar atë vetëm nëpërmjet përdorimit të likuiditeteve në *cash* për financimin e kësteve dhe pa ndryshuar asnjë element tjetër të analizës që ka bërë Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte kursime në *cash* të mjaftueshme për të financuar pagimin e shumës 22.000 euro, e konvertuar në 3.053.820 lekë, në datën 17.12.2010, si edhe kursime në *cash* të mjaftueshme për të financuar pagimin e shumës 2.117.300 lekë, në datën 25.02.2011.

18. Marrëdhënia e huamarrjes së përkohshme e subjektit me vëllezërit

18.1. Subjekti ka deklaruar në DPV-2011 se ka paguar këstin e dytë të apartamentit në vitin 2011, i cili është në vlerën prej 51.687 euro, në datën 29.07.2011. Kjo vlerë e çmimit të apartamentit përbëhet nga vlera prej 5.000.000 lekësh, e përfituar nga kredia me kushte lehtësuese, nga Banka BKT, dhe diferenca prej 2.117.330 lekësh, e paguar fillimit prej subjektit, në muajin shkurt 2011, e cila është analizuar më lart. Subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ se shuma e disbursuar e kredisë nuk i është kaluar drejtpërdrejt palës shitëse, shoqërisë “{***}” ShPK, por duke qenë se shoqëria kërkonte domosdoshmërisht të gjithë pagesën në monedhën euro, ashtu siç ishte edhe përcaktuar çmimi në kontratën paraprake me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., të datës 17.12.2010, subjekti ka huazuar për disa ditë shumën prej 51.687 euro, nga vëllezërit e saj, që ushtronin aktivitet në fushën e kambizmit, të cilën ia ka paguar shoqërisë. Më pas, subjekti pretendon se me disbursimin e kredisë, së bashku me kursimet e saj të parapaguara në muajin shkurt 2011, ka shlyer këtë detyrim ndaj vëllezërve të saj.

18.2. Lidhur me këtë pagesë të apartamentit, përveç sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se:

i. Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar huan e përkohshme që ka pretenduar të marrë nga vëllai i saj, si në DPV-të vjetore, ashtu edhe në atë vetting. Ky mosdeklarim merr peshë në raport me mosdeklarimin e saj përgjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, si dhe për faktin se subjekti dispononte likuiditet cash në fund të vitit 2010, në shumën 5.326.871 lekë, çka bënte të panevojshme marrjen e kësaj huaje [...].

ii. Trupi gjykues çmon se këto fakte, në harmoni me njëri-tjetrin, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaratimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me vërtetësinë e burimeve të kësaj pasurie dhe destinacionin e tyre. Kjo situatë faktike në çmuarjen e trupit gjykues krijon kushtet që kjo problematikë të vlerësohet në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e kualifikuar si një ndër shkaqet për aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

18.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta konkluzionet e Komisionit lidhur me huamarrjen nga vëllezërit, pasi nuk përputhet me të vërtetën e saj jetësore, dhe se Komisioni nuk ka mundur të provojë se vëllezërit nuk kishin të ardhura të ligjshme për t'i huazuar subjektit vlerën në euro, të paguar për likuidimin e këstit të dytë të apartamentit në Tiranë.

18.4. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakut ankimi, e sheh të nevojshme prezantimin e disa fakteve që kanë rezultuar nga hetimi, të cilat më pas iu nënshtruan analizës prej trupit gjykues edhe në këndvështrim të kuadrit ligjor të zbatueshëm.

18.5. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e dhëna për Pyetësonin nr. 2 të Komisionit, nëpërmjet të cilit i janë kërkuar shpjegime lidhur me modalitetet e pagesës së këstit të dytë të apartamentit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “Vlera 51.687 euro i është marrë vëllait në mirëbesim më datën 29.07.2011, por kundërvlehtë në monedhën lekë i është paguar atij disa ditë më pas. Në datën 05.08.2011, unë kam bërë tërheqjen në bankë të vlerës 5,000,000 lekë, shumë të cilën ia kemi dorëzuar vëllait T. Q., së bashku me vlerën 2.117.300 lekë (ndoshta edhe ndonjë shumë tjetër e vogël sipas kursit të këmbimit), e cila na ishte kthyer cash nga administratori/pronari i shoqërisë, z. H. F., po atë ditë. Pra, vëllait i është paguar/dhënë në ditët e para të muajit gusht të vitit 2011,

vlera përkatëse në lekë, si kundërvleftë e shumës 51.687 euro, e cila na ishte dhënë prej tij për të paguar shumën 51.687 euro, në datën 29.07.2011”.

18.6. Nga aktet e administruara prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, përkatësisht nga të dhënat e përcjella nga Banka BKT, rezulton se më datë 25.02.2011, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e saj bankare shumën 2.150.000 lekë dhe, në të njëjtën ditë, ka transferuar te llogaria bankare e shoqërisë “{***}” ShPK, si pagesë të pjesshme të vlerës së mbetur, shumën 2.117.300 lekë. Nga të dhënat e *statementeve* bankare rezulton se shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, shumën e mësipërme të paguar e ka tërhequr nga llogaria e saj dhe ia ka kthyer subjektit *cash*, në sportelet e bankës, për shkak se në kontratën noteriale (me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., të datës 17.12.2010), palët kishin dakordësuar se kësti i dytë, në shumën 51.687 euro, do të likuidohet në momentin që pala blerëse do të përfitojë një kredi bankare te BKT Tiranë. Nga të dhënat e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se kredia me kushte lehtësuese i është disbursuar subjektit në monedhën lekë, nga Banka BKT, në datën 26.07.2011, dhe 3 ditë më vonë, më datë 29.07.2011, kredia në vlerën 5.000.000 lekë nga subjekti u transferua nëpërmjet transaksionit bankar te llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën BKT, me përshkrimin: *“Kalim kësti i fundit për blerje apartamenti”*. Sërish, shoqëria “{***}” ShPK, edhe këtë pagesë ia rikthen subjektit, duke përshkruar në transaksionin bankar, po të datës 29.07.2011: *“Kthim shume pasi do të paguhet në euro”*. Pas këtyre veprimeve, rezulton se po më datë 29.07.2011, personi i lidhur ka kryer në sportelet e Bankës BKT, depozitim *cash* në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, shumën 51.687 euro, për të cilën subjekti ka shpjeguar se, për disa ditë, ia ka marrë hua vëllezërve të saj, të cilët ushtronin aktivitet privat në fushën e këmbimit valutor dhe, për rrjedhojë, kishin mundësi t’i siguronin këtë shumë. Në vijim, nga analizimi i veprimeve të rezultuara nga *statementi* i llogarisë bankare të subjektit, rezulton se, më datë 05.08.2011, ka tërhequr nga llogaria e saj shumën e kredisë në vlerën 5.000.000 lekë, të cilën e ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se e ka tërhequr për t’ia kthyer vëllezërve të saj.

18.7. Komisioni, pasi është njohur me këto fakte, i ka konsideruar vëllezërit si persona të tjerë të lidhur të subjektit, për të cilët, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e tyre për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit, në korrik 2012, dhe ka konkluduar²¹ që duket se ata kanë pasur disponibilitet të shumës 51.687 euro, për t’ia huazuar përkohësisht subjektit. Pavarësisht këtij qëndrimi, Komisioni lidhur me këtë hua ka arsyetuar gjithashtu se: *subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar/specifikuar marrjen dhe përdorimin e përkohshëm të fondeve prej 51.687 euro nga vëllai i saj, në deklaratën vetting - (si burim i përdorur fillimisht në momentin e pagesës, ndonëse për një periudhë të shkurtër njëjavore) - apo përgjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, në vitin 2016*. Për rrjedhojë, Komisioni nuk e ka njohur këtë hua si burim për financimin e përkohshëm të këstit të dytë të apartamentit, duke konkluduar se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për justifikimin e këtij shpenzimi. Në pikën fundore, pavarësisht këtyre qëndrimeve, duket se Komisioni ka përfshirë kredinë prej 5.000.000 lekësh në analizën financiare, duke përmbysur praktikisht të gjithë logjikën e përdorur më lart, sipas së cilës subjekti nuk provon marrëdhënien e huas me vëllezërit dhe as marrjen prej tyre përkohësisht të shumës së

²¹ Shih paragrafët 18.61 dhe 18.66 të vendimit të Komisionit, në të cilët është konkluduar se: [...] Gjithashtu, nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare dhe nga niveli i parave të qarkulluara prej vëllezërve të subjektit – i cili gjatë vitit 2011 ka qenë së paku rreth 925.000 euro dhe rreth 1.3 milionë euro gjatë vitit 2010 – duket se ata mund të kenë pasur disponibilitet të shumës 51.687 euro, për t’ia huazuar përkohësisht subjektit.

paguar palës shitëse, që do të duhej logjikisht të mos vijonte me përdorimin e kredisë si burim për pagesën e këstit të dytë. Pavarësisht këtyre qëndrimeve kontradiktore të Komisionit, trupi gjykues e vlerësoi të rëndësishme, në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve të subjektit, por edhe verifikimit për pasjen e likuiditeteve me burim të ligjshëm në momentin e pagimit të shumës prej 51.687 euro, të marrë në analizë deklarimet/shpjegimet lidhur me marrëdhënien e huas me vëllezërit, krahas të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni bankar.

18.8. Në analizë të sa evidentuar më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje disa elemente që bëjnë të besueshëm, në vlerësimin e tij, shpjegimin që jep subjekti për situatën. Së pari, konstatohet se pretendimi i subjektit, se shoqëria shitëse “{***}” ShPK kërkonte që të merrte prej subjektit vlerën që i detyrohej prej kontratës së shitjes vetëm në monedhën *euro*, siç edhe kontrata përcaktonte, duket i besueshëm. Në këtë konkluzion arrihet duke konsideruar dy momente të rëndësishme financiare, të cilat nuk mund të kenë një shpjegim të ndryshëm nga ky i përshkruar më lart. Kështu, rezulton se në datën 25.02.2011, subjekti ka depozituar për llogari të shoqërisë shitëse shumën prej 2.117.330 lekësh, si një pjesë e këstit të dytë të apartamentit, ky veprim konfirmohet nga *statementi* bankar, sipas të cilit është kryer ky depozitim. Në vijim, sipas të dhënave të *statementit* bankar të lëshuar nga BKT, për llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, rezulton se kjo shoqëri, po më datë 25.02.2011, ka tërhequr në *cash*, këtë shumë, të cilën subjekti pretendon se ajo ka vijuar ta disponojë atë, me qëllim bashkimin me shumën që do të disbursohet prej kredisë, për të konstituuar shumën totale prej 51.386 eurosh, që ajo i detyrohej kësaj shoqërie.

18.9. Gjithashtu, vlen të sillet në vëmendje momenti tjetër që lidhet me disbursimin e kredisë në llogarinë e subjektit, në datën 26.07.2011, të cilën subjekti u përpoq ta përdorte për shlyerjen në mënyrë direkte të detyrimit të saj për këstin e dytë të apartamentit, pagesë e cila nëpërmjet bankës u kthye mbrapsht nga shoqëria e ndërtimit, duke kërkuar shlyerjen e detyrimit në monedhën *euro*, siç përcaktonte kontrata paraprake. Në këto kushte, për të shlyer këtë detyrim, subjekti ka preferuar të huazojë shumën totale në monedhën *euro*, nga vëllezërit e saj dhe ta depozitojë në *cash*, në sportelet e bankës, në llogarinë e shitësit, po në datën 29.07.2011, në të njëjtën ditë kur shoqëria e ndërtimit i kishte kthyer pagesën e shumës 5.000.000 lekë. Kredia e disbursuar është tërhequr më pas prej subjektit, në datën 05.08.2011, dhe sipas saj i është kthyer vëllezërve, të cilët kishin mundësuar nëpërmjet huas së përkohshme pagimin e këstit të dytë të apartamentit.

18.10. Për sa më sipër, shpjegimi i subjektit se marrja e “huas” prej vëllezërve ishte veprimi më i favorshëm për të, për shkak të aktivitetit të shkëmbimit valutor që vëllezërit ushtronin, i cili mundësonte konvertimin në kursin më të favorshëm të shumës së marrë kredi dhe kursimeve në disponim, nga lekë në monedhën *euro*, duket i besueshëm. Në këtë kontekst merr kuptim edhe fakti që pala shitëse tërheq menjëherë shumën e paguar në shkurt të vitit 2011 dhe ia kthen atë subjektit, duke preferuar të këtë njëherazi në zotërim të gjithë shumën e mbetur pa shlyer, prej 51.387 eurosh. Kjo situatë gjen pasqyrim edhe te raportimet ditore të veprimtarisë së këmbimit valutor prej shoqërisë së vëllezërve të subjektit, të emërtuar “{***}” ShPK, të cilat ndonëse janë akte të lëshuara prej vetë shoqërisë, pra të njëanshme, duket se kanë të pasqyruar në to pikërisht veprimin financiar të kryer në datën 29.07.2011. Sipas këtij akti, vëllai i subjektit, z. T. Q., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ka kryer brenda kompanisë transaksion shitblerje valute, në shumën 51.000 *euro*, të cilën e ka identifikuar si veprim të bërë në favor të “individit, kunatit”, veprime të cilat duket se konfirmojnë atë që subjekti ka deklaruar/shpjeguar gjatë hetimit administrativ. Mbi të gjitha, fakti që subjekti

dispononte në kohën e kryerjes së pagesës ndaj palës shitëse, të gjithë shumën që i detyrohej asaj, në monedhën lekë, kredi e disbursuar 5.000.000 lekë dhe kursime në zotërim në vlerën 2.117.330 lekë, pavarësisht se ajo përdori për një kohë të shkurtër, 5-ditore, fondet e vëllait të saj në monedhën euro, krijon për trupin gjykues bindjen se marrja e kësaj shume hua, nuk vjen për shkak të mungesës së burimeve financiare, por për shkak të administrimit të procesit të pagimit të kështit të dytë në një vlerë sa më të favorshme për subjektin, në raport me kursin e këmbimit në atë kohë.

18.11. Në analizë të sa më lart, trupi gjykues i gjen bindëse shpjegimet e subjektit për transaksionet financiare të ndodhura mes saj dhe vëllezërve, për likuidimin e kështit të dytë të apartamentit.

18.12. Në lidhje me mosdeklarimin prej subjektit të marrjes së kësaj huaje në deklaratën *vetting*, trupi gjykues vlerëson se duhet konsideruar si një fakt që nuk mund të prodhojë një pasojë ndëshkuese për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar disa rrethana, që e bëjnë të kuptueshëm këtë mosdeklarim dhe e zhveshin atë prej tipareve të një deklarimi të pasaktë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues e gjeti pa peshë përcaktuese analizën e Komisionit për këtë marrëdhënie dhe shpjegimet e subjektit bindëse, edhe për shkak të faktit se, pavarësisht rezervave lidhur me marrëdhënien e përkohshme të huas mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve të saj, në periudhën 29.07.2011 – 05.08.2011, ka pranuar dhe përlogaritur në analizën financiare, kredinë prej 5.000.000 lekësh të marrë prej BKT-së, si burim për shlyerjen e plotë të çmimit të kësaj pasurie.

18.13. Në përfundim lidhur me këtë çështje, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë edhe pasjen prej vëllezërve të subjektit, të cilët kryejnë aktivitet të licencuar në tregun e këmbimit valutor, të likuiditeteve financiare për të huazuar/konvertuar nga monedha lekë në euro, për një periudhë disaditore, shumën e destinuar për pagimin e vlerës së plotë të çmimit të apartamentit, si edhe gjurmët e veprimeve bankare të kryera prej subjektit dhe të bashkëshortit për përdorimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, vlerëson se përfshirja në analizë prej Komisionit e kësaj shume si burim për krijimin e pasurisë, vjen në harmoni me të dhënat që japin aktet e administruara për këtë moment. Vlerësimi i Komisionit lidhur me mosdeklarimin e marrëdhënies së subjektit me vëllezërit e saj për huazimin/konvertimin e shumës së përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj palës shitëse, nuk u gjet me peshë përcaktuese lidhur me këtë moment, për sa kohë që analiza financiare e kryer në Komision, e ka njohur si të ligjshme të ardhurën e përfituar prej kësaj marrëdhënie në kushtet e përshkruara më lart.

18.14. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se përfshirja në analizën financiare të Komisionit e kredisë në vlerën prej 5 milionë lekësh, konfirmon që ajo është konsideruar së bashku me kursimet në vite, si burim për krijimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht transaksioneve/veprimeve të kryera prej kësaj të fundit gjatë një periudhe të shkurtër kohore me vëllezërit e saj.

19. Obligacionet në “Credins Bank” dhe llogaria rrjedhëse në Bankën BKT, të krijuara në vitin 2016

19.1. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit lidhur me konkluzionet e Komisionit për pasurinë “Obligacione” të blera prej asaj në vitin 2016, në “Credins Bank” dhe likuiditet në llogarinë rrjedhëse në BKT, të krijuara po ashtu në vitin 2016. Këto pasuri janë krijuar sipas deklaratimit të subjektit si derivat i një depozite të krijuar në vitin 2012 dhe të tërhequr në vitin 2014, si edhe nga përdorimi i gjendjes në *cash* të akumuluar deri në ditën e krijimit të llogarisë rrjedhëse.

Subjekti ka kontestuar konkluzionet e Komisionit lidhur me këto pasuri, duke pretenduar se janë të gabuara dhe në kundërshtim me atë që subjekti ka deklaruar në vite, si edhe ka shpjeguar hollësisht në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në mars të vitit 2016. Gjithashtu, subjekti, duke pohuar pasaktësinë në deklarimin e kredisë si burim krijimi edhe për pasurinë *Apartament*, edhe për *Likuiditet*, ka shpjeguar se vendosja e saj në rrethin e burimeve për këto pasuri ka ardhur për shkak se ajo ka synuar të potencojë të vetmet burime për pasuritë e saj, të cilat janë kursimet dhe kredia.

19.2. Komisioni, në analizën e kryer për burimet e krijimit të këtyre pasurisë, është mbështetur kryesisht në leximin formal të deklaratave periodike të viteve 2012, 2015 e 2016 të subjektit të deklarimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si ai i mbajtur në raport me leximin e deklaratave periodike të viteve 2010 dhe 2011, për pagimin e kësteve të apartamentit. Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar pakësime apo shtesa të gjendjes së *cash-it* shprehimisht në këto deklarata, si edhe ka deklaruar edhe kredinë si burim për krijimin e këtyre pasurive, Komisioni, nëpërmjet një leximi literal të tyre, ka konkluduar se subjekti nuk e ka përdorur gjendjen e *cash-it* për krijimin e një depozite në vitin 2012, as nuk e ka shtuar gjendjen e *cash-it* nga tërheqja e saj në vitin 2014 dhe as e ka përdorur këtë gjendje për blerjen e obligacioneve apo depozitimin në llogari rrjedhëse të shumave përkatëse, në vitin 2016. Analiza e kryer nga Komisioni për këto dy pasuri *likuiditet*, konsiston pikërisht në leximin e deklaratave periodike, duke i konsideruar ato së bashku me deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting* për përdorimin e kredisë, si të pasakta, dhe jo në ndonjë rrethanë tjetër që lidhet me të ardhurat apo shpenzimet e subjektit në këtë periudhë. Për pasojë, edhe trajtimi që trupi gjykues i bëri këtij shkakut ankimi që lidhet me këto pasuri, iu dedikua deklaratimeve të subjektit lidhur me to.

19.3. Për analizimin e pretendimeve të subjektit lidhur me konkluzionet e Komisionit për pasurinë *Obligacione në “Credins Bank”*, trupi gjykues shqyrtoi të dhënat e mëposhtme, të cilat rezultojnë, por jo vetëm, nga deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratat e pasurisë, nga të cilat konstatoi sa vijon:

- i. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se disponon obligacione pranë “Credins Bank”, në vlerën 2.000.000 lekë, me afat 5-vjeçar. Burimi: *Të ardhurat nga kursimet e punës dhe të kredisë*.
- ii. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerje obligacionesh, në vlerën 2.000.000 lekë, pranë “Credins Bank” Lushnjë, me interes 6.4%, për të cilat nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të përdorur për financimin e tyre.
- iii. Në DPV-2015, e cila është depozituar në ILDKPKI, më datë 21.03.2016, rezulton se, edhe pse ishin veprime që i përkisnin vitit 2016, subjekti i ka pasqyruar veprimet e kryera deri në momentin e dorëzimit të kësaj deklarate, pra deri në mars 2016, duke deklaruar: *Cash-in në banesë e kam reduktuar, konkretisht më datë 03.02.2016, kam depozituar 2.000.000 lekë në “Credins Bank”, për emetimin e letrave me vlerë [...]*.
- iv. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 21.03.2016, subjekti ka deklaruar se: *gjendjen e cash-it të disponuar e ka pakësuar në vitin 2016, duke futur në sistemin bankar shumën 2.000.000 lekë (BKT) dhe ka deklaruar se do të vazhdojë të pakësojë gjendjen e cash-it nën pragun 1.500.000 lekë*.
- v. Në DPV-2012, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës pranë Bankës “Credins”,²² me vlerë 3.000.000 lekë, me burim krijimi: *“Kursimet dhe kredinë”*.

²² Në DPV-2012, subjekti deklaron se depozita është në “ProCredit Bank”, por realisht ajo është në “Credins Bank”.

vi. Sipas *statementit* të lëshuar nga Banka “Credins”, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në momentin e derdhjes së shumës prej 3.000.000 lekë në depozitën bankare, si burimin e fondeve që ka depozituar në atë moment në bankë, ka deklaruar: “*Të ardhura nga puna e kryer*”.

19.4. Nga sa përshkruar më lart, trupi gjykues konstaton se deklaratimet e mësipërme të bëra nga subjekti, japin informacionin se blerja e obligacioneve, më datë 03.02.2016, në shumën 2.000.000 lekë, është financuar me kursimet në *cash* që ajo dispononte, reduktimin/pakësimin e të cilave e ka deklaruar në DPV-2015, në masën 2.000.000 lekë, pra në të njëjtën vlerë që janë blerë edhe obligacionet. Në kushtet kur burimi i shumës 2 milionë lekë, që ka shkuar për blerje obligacionesh, rezulton të jetë identifikuar qartësisht nga subjekti në DPV-2015, si e marrë nga kursimet në *cash*, duke i reduktuar ato në këtë vlerë, analiza e Kolegjit u ndal në verifikimin e mundësisë së subjektit për të disponuar këto kursime në *cash*, duke verifikuar gjendjen e *cash-it* të zotëruar prej saj deri në datën 03.02.2016, në të cilën është kryer blerja e tyre. Përveç deklaratimeve të bëra në deklaratat periodike për shtesat e gjendjes *cash*, një rol të posaçëm në krijimin e kësaj gjendje si burim për financimin e obligacioneve, luan një depozitë bankare e krijuar prej subjektit në vitin 2012, e cila u tërhoq prej saj në vitin 2014. Subjekti ka pretenduar se gjendja e *cash-it* që dispononte në kohën e blerjes së obligacioneve, është dominuar prej likuiditeteve të kësaj depozite, të cilat pasi janë tërhequr në vitin 2014, janë mbajtur *cash* në banesë. Komisioni, si pasojë, ka verifikuar qoftë burimin e krijimit të kësaj depozite në vitin 2012, ashtu edhe faktin nëse tërheqja e saj në vitin 2014 ka shtuar apo jo gjendjen e *cash-it* të subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues analizoi faktet që u përmendën më lart, për t’i dhënë zgjidhje shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri si vijon:

19.5. Në DPV-2012, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës pranë Bankës “Credins”, me vlerë 3.000.000 lekë, me burim krijimi “*kursimet dhe kredinë*”. Përmendja e kredisë si burim i depozitës në “Credins Bank”, duket se e ka shtyrë Komisionin të ketë paqartësi lidhur me përdorimin e saj vetëm për pagesat e apartamentit apo edhe për krijimin e depozitës në vitin 2012. Në ankim, subjekti ka shpjeguar, siç u referua më lart, se përfshirja e kredisë si burim për financimin e blerjeve të obligacioneve, në vitin 2016, dhe të çeljes së depozitës në BKT Bank, po në vitin 2016, është një “lapsus”.

19.6. Trupi gjykues, për sa më lart, analizoi fillimisht deklaratimet dhe rrethanat e tjera të rezultuara nga hetimi administrativ, në funksion të përcaktimit të saktë të faktit se cili ka qenë burimi i krijimit të kësaj depozite bankare në vitin 2012. Kjo analizë u mbështet kryesisht në të dhënat që provojnë qëllimin dhe marrjen e më pas përdorimin e kredisë bankare prej subjektit, si një metodë alternative për të përjashtuar këtë burim nga krijimi i depozitës.

Në këtë kontekst rezultoi se: **(i)** Subjekti në vitin 2010 ka kërkuar të përfshihet në listën e prokurorëve që kërkojnë të trajtohen me kredi lehtësuese. **(ii)** Subjekti, pasi ka marrë aprovimin nga Prokuroria e Përgjithshme për t’u përfshirë në listën e personave që përfitojnë kredi për strehim, po në vitin 2010, ka lidhur kontratë noteriale paraprake shitje me nr. {***}, datë 17.12.2010, për blerjen e një apartamenti, për të cilin ka paguar këstin e parë dhe ka nënshkruar një deklaratë noteriale nr. {***}, datë 23.12.2010, në të cilën palët “{***}” ShPK dhe Merita e A. Selimi përcaktojnë se detyrimi i mbetur i papaguar nga çmimi i apartamentit, në shumën 51.683 euro, do të paguhet nëpërmjet marrjes së një kredie bankare, që subjekti dhe bashkëshorti do të marrë nga Banka BKT, në shumën 5.000.000 lekë. **(iii)** Në kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., të lidhur më datë 26.02.2012, ndërmjet palëve, Banka BKT dhe Merita e A. Selimi, në aneksin e emërtuar “Elementet

specifike të kredisë” përcaktohet se kredia do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK. (iv) Në DPV-2010, subjekti, si burime të financimit të apartamentit, ka deklaruar: “Kursimet nga puna 22-vjeçare dhe kredia 5.000.000 lekë”. (v) Në DPV-2011, subjekti ka deklaruar: “Paguar vlera 51.687 euro nga këto 5.000.000 lekë kredi”, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Se apartamenti është financuar nga kursimet e 30 viteve punë, si dhe një pjesë të kredisë 5.000.000 lekë”.

19.7. Në vlerësimin e trupit gjykues, të dhënat e mësipërme evidentojnë se kredia ka shkuar tërësisht për pagesën e apartamentit në Tiranë, vlerë e cila, për më tepër në analizën e Komisionit, është përfshirë e gjitha si burim për financimin vetëm për këtë pasuri. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se fakti që subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *vetting* kredinë me kushte lehtësuese si burim edhe për obligacionet, edhe për llogarinë në Bankën BKT, jo vetëm e bën të drejtë konkluzionin e vendimit të Komisionit, se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me të, por gjithashtu përcakton se si burim i krijimit të këtyre pasurive *likuiditete* kanë shërbyer vetëm kursimet e subjektit nga puna e saj dhe të personit të lidhur, dhe vetëm mbi analizën e tyre mund të verifikohet mundësia e subjektit për krijimin e pasurisë *Obligacione* në “Credins Bank”, por edhe të llogarisë rrjedhëse në BKT, të krijuara në vitin 2016.

19.8. Lidhur me verifikimin e burimeve të krijimit të depozitës në Bankën “Credins”, në vitin 2012, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke qenë se ajo nuk e ka deklaruar pakësimin e kursimeve në *cash* si burim për krijimin e depozitës në mars të këtij viti, në vlerën prej 3.000.000 lekë, nga tërheqja e së cilës, në vitin 2014, kanë buruar të ardhurat për blerjen e obligacioneve në Bankën “Credins”, si edhe pjesërisht të çeljes së llogarisë bankare në BKT, në datën 23.03.2016.

19.9. Trupi gjykues, pas një analize harmonike të deklarimeve të subjektit sipas akteve të sipërpërmendura në paragrafin 19.6, arrin në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni për sa i përket këtij fakti. Siç është arsyetuar edhe më lart, Komisioni ka trajtuar përdorimin e kursimeve prej subjektit si burim për krijimin e pasurive të saj, vetëm në raport me mospërdorimin e termit *pakësim* të tyre, siç nënkuptohet se ligji nr. 9049/2003 kërkon. Ndërsa edhe në këtë rast, ashtu si edhe në përdorimin e tyre për pagimin e kësteve të apartamentit apo krijimin e obligacioneve e të llogarive bankare, subjekti i deklaroi kursimet në deklaratën *vetting* si burim për krijimin e pasurive, ashtu siç i deklaroi edhe në deklaratat periodike. Ajo që subjekti mungon të deklarojë, është pakësimi i tyre në një vlerë të caktuar. Trupi gjykues, edhe në këtë rast, vlerëson se leximi që Komisioni i ka bërë deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike ka qenë skematik dhe jo harmonik me të gjithë frymën e ligjit dhe modelin e ndjekur për deklaram prej subjektit në të gjitha deklaramet e saj, të cilat shoqërohen nga një qasje e njëjtë në këtë drejtim. Lidhur me depozitën e krijuar në “Credins Bank”, në vlerën prej 3.000.000 lekë, në vitin 2012, subjekti rezulton të ketë deklaruar në DPV-2012 se është krijuar me burim *nga kursimet dhe kredia*, dhe duke përjashtuar kredinë sipas arsyetimi të bërë më lart, mbeten kursimet që subjekti dispononte, si i vetmi burim për krijimin e saj. I njëjti deklaram vjen si indicie edhe nga deklarimi që subjekti ka bërë në bankë, kur ka kryer depozitim në *cash* të shumës, duke deklaruar *se të ardhurat janë krijuar nga puna*, e cila qartësisht nuk mund të ishte vetëm ajo e periudhës 1 janar – mars 2012, për shkak të vlerës së lartë që depozitohej, por logjikshëm puna referohej si burim për krijimin e të ardhurave në vite që janë akumuluar si kursime të subjektit.

19.10. Përfundimisht, trupi gjykues, pasi analizoi deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, se ka krijuar depozitën në Bankën “Credins” me kursime dhe kredinë, si edhe shpjegimet e hollësishme në mbështetje të këtij deklarimi në procesverbalin e ILDKPKI-së, arriti në përfundimin se moskonsiderimi i burimit *kursime* vetëm për shkak të mosdeklarimit të pakësimit të kursimeve në *cash*, është një lexim e interpretim i kufizuar i informacionit që jep deklarata periodike. Për pasojë, kursimet u konsideruan si burim për krijimin e kësaj depozite, në konsideratë edhe të vlerës provuese të deklaratave periodike, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19.11. Në këto kushte, trupi gjykues u ndal në verifikimin e mundësisë së subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 3.000.000 lekë, të kredituar në datën 21.03.2012, në Bankën “Credins”. Në konsideratë të qëndrimeve të mësipërme, në Kolegj analiza financiare u bë duke reflektuar pakësimin e gjendjes së *cash*-it prej (-) 2.482.700 lekë, të disponuar në banesë dhe të krijuar me burime të ligjshme. Pas përfshirjes së kësaj shume si burim krijimi i depozitës bankare, nga analiza²³ e kryer u konstatua se subjekti i rivlerësimit, në datën 21.03.2012, të çeljes së kësaj depozite, rezultonte me pamundësi financiare në shumën (-) 470.068 lekë.

19.12. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim deklaratimet e subjektit lidhur me tërheqjen e shumës së depozituar në këtë depozitë në vitin 2014, e cila pretendohet prej saj se është mbajtur në gjendje *cash* në banesë deri në fillim të vitit 2016, kur është përdorur për blerjen e obligacioneve në Bankën “Credins”. Komisioni nuk e ka konsideruar se kjo tërheqje ka shtuar gjendjen e *cash*-it të subjektit, sepse ajo nuk e ka deklaruar shprehimisht këtë shtesë dhe, për pasojë, nuk e ka njohur më pas këtë gjendje si burim për blerjen e obligacioneve.

19.13. Në verifikim të të dhënave që rezultojnë lidhur me këtë situatë, trupi gjykues konstaton se depozita e çelur nga subjekti në vitin 2012, sipas *statementeve* të Bankës “Credins” është mbyllur më datë 31.07.2014. Subjekti e ka përshkruar këtë veprim në deklaratimet e saj në vitin korent, të cilat u analizuan nga trupi gjykues në mënyrë harmonike edhe me rrethanat e tjera, që sugjerojnë për një lexim të kujdesshëm të tyre në këndvështrim të shpjegimeve që ka dhënë vetë subjekti, por edhe të frymës së ligjit nr. 9049/2003.

19.14. Në këtë kontekst konstatohet se subjekti ka deklaruar në DPV-2014, në “Seksionin e ndryshimit të pasurive dhe burimi i krijimit të tyre”, “*tërheqje depozite*²⁴ nga Banka “Credins” dhe interesa, në shumën 3.189.130 lekë”, duke e pozicionuar këtë ndryshim të situatës lidhur me likuiditetin pikërisht në seksionin që tregon ndryshimet e pasurisë dhe jo të ardhurat. Sipas këtij leximi, gjendja likuiditet është transformuar për shkak të mbylljes së depozitës nga likuiditet në bankë në gjendje *cash*, veprim i cili është barazuar me shtimin e pasurisë në këtë gjendje sipas deklarimit në këtë seksion. Nga hetimi nuk ka rezultuar që subjekti në këtë vit të ketë investuar në blerje pasurish apo të ketë kryer shpenzime të tjera, që mund të jenë përballuar nga shuma e tërhequr prej depozitës.

²³ Në analizën e kryer në Kolegj u përfshinë përkatësisht:

- Të ardhura nga pagat 01.01.2012 – 21.03.2012, në shumën 153,000 lekë.
- Kursime të mbetura *cash* nga viti 2011, në shumën 2,482,700 lekë (1.882.700 lekë të mbetura nga gjendja e *cash*-it pas pagesës së kështit të dytë të apartamentit, në shkurt 2011, + 600.000 lekë shtesë e gjendjes së *cash*-it, e deklaruar në DPV-2012).
- Shpenzime të familjes, 01.01.2012 – 21.03.2012, në shumën (-) 105,768 lekë.
- Investimi në depozitë me afat, më datë 21.03.2012, në shumën (-) 3.000.000 lekë.

²⁴ Sipas Komisionit, deklarimi i subjektit nuk është i plotë, pasi për këto fonde të tërhequra nuk është deklaruar nëse ato janë përdorur apo janë gjendje *cash* në banesë.

Sipas deklarimeve të subjektit në vite, kursimet e krijuara nga puna e kanë shoqëruar të gjithë jetën financiare të subjektit dhe duket se kanë shërbyer për investimet në pasuritë e krijuara prej saj, qasje e cila duket se përjashton versionin e një shpenzimi brenda vitit të një shume që përfaqëson kursimet e shumë viteve, pa një qëllim të shpallur apo një nevojë të pashmangshme, rrethana të cilat nuk rezultojnë se kanë ndodhur.

19.15. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e subjektit në DPV-2015, në të cilën ka deklaruar se, më datë 03.02.2016, ka kryer pakësimin e gjendjes së *cash*-it në shumën 2.000.000 lekë, me qëllim depozitimin e shumës në bankë për blerje të letrave me vlerë dhe se, në datën 23.03.2016, ka reduktuar kursimet në *cash* po me vlerën 2.000.000 lekë, duke bërë derdhje në llogarinë rrjedhëse të pagës pranë Bankës BKT. Po ashtu në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 21.03.2016, subjekti ka shpjeguar (në përgjigjet e pyetjes nr. 4) se gjendjen e *cash*-it të disponuar e ka pakësuar në vitin 2016, duke futur në sistemin bankar shumën 2.000.000 lekë (BKT) dhe ka deklaruar se do të vazhdojë të pakësojë gjendjen e *cash*-it nën pragun 1.500.000 lekë. Nga këto deklarime, pavarësisht se të deklaruara më herët në kohë, në DPV-2015, kur ato i përkasin periudhës së deklaramit të vitit 2016, por që janë prodhuar para deklaratës *vetting*, rezultojnë qartësisht se burimi i deklaruar prej subjektit për blerjen e obligacioneve kanë qenë kursimet në *cash*, që ajo ka pasur në banesë deri në fund të vitit 2015.

19.16. Në përmbyllje të këtij arsyetimi, duke analizuar deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2015, në harmoni me shpjegimet në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23.03.2016 dhe deklarimin e bërë në deklaratën periodike të vitit 2014, se ajo ka tërhequr shumën prej 3.189.130 lekësh, duke mbyllur depozitën e hapur në vitin 2012, si përshkruar më lart, tërheqje, të cilën e ka referuar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë në këtë deklaratë, trupi gjykues e konsideroi bindës shpjegimin se këto para janë të disponuara në formën e gjendjes *cash*, dhe kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “Obligacione”, dhe si të tilla ato iu nënshtroan verifikimit nga ana e trupit gjykues nëse mund të përballonin krijimin e kësaj pasurie.

19.17. Në të njëjtën logjikë analize, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe shkakun e ankimit lidhur me krijimin e llogarisë rrjedhëse në Bankën BKT, në shumën 2.000.000 lekë, në vitin 2016, për të cilën subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit se ajo ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, duke përsëritur të njëjtat argumente, si ato që lidheshin me krijimin e pasurisë “Obligacione”.

19.18. Komisioni, lidhur me këtë pasuri të krijuar prej subjektit, me depozitimin në Bankën BKT të shumës prej 2.000.000 lekësh, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sipas të cilit nuk i ka njohur asaj përdorimin e kursimeve si burim, për shkak të mosdeklarimit të pakësimit të tyre, si edhe për shkak të faktit se tërheqja e depozitës në vitin 2014, sipas asaj që u pasqyrua më lart, nuk kishte krijuar gjendje *cash*, për pasojë subjekti nuk kishte mjete monetare në disponim për depozitimin e kësaj shume në llogarinë rrjedhëse.

19.19. Për t'i dhënë përgjigje shkakut të ankimit që lidhet me këtë pasuri, trupi gjykues mbajti në konsideratë disa rrethana si vijon:

- i. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse pranë Bankës BKT, me gjendje 2.810.633 lekë, me burim nga *kursimet e punës dhe të kredisë*.

- ii. Në DPV-2015, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes së *cash*-it prej 2.000.000 lekë, me qëllim depozitimin e shumës në “Credins Bank” për blerje të letrave me vlerë, si dhe 2.000.000 lekë, më 23.03.2016, në llogarinë rrjedhëse të pagës në BKT.
- iii. Në DPV-2016, subjekti ka deklaruar: *Llogari rrjedhëse pranë Bankës BKT Lushnjë, në vlerën 2.772.346 lekë, me burim të ardhurat nga kursimet e punës dhe të kredisë. Shënim: 2.000.000 lekë derdhur nga cash ndër vite dhe një pjesë kredie pas kontrollit në ILDKPKI, për vitin 2015 (datë 21.03.2016). Kursime nga të ardhurat e pagës për vitin 2016, në shumën 701.964 lekë.*
- iv. Subjekti, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në mars 2016, ka shpjeguar se: *Depozitën në “Credins Bank”, të mbyllur në vitin 2014, prej 3.000.000 lekë, e kam kaluar gjendje cash në banesë, që shkon në një total prej 4.469.130 lekë. Dua të theksoj se këtë gjendje cash, unë e kam pakësuar në vitin 2016, duke futur në sistemin bankar shumën 2.000.000 lekë dhe shtoj se do e ul këtë gjendje nën pragun 1.500.000 lekë.*

19.20. Trupi gjykues vlerëson të risjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur në paragrafin 19.7 më sipër, lidhur me kredinë si burim krijimi për pasurinë “Obligacione”, i cili vlen edhe për llogarinë bankare në Bankën BKT, duke konfirmuar deklarinë e pasaktë të subjektit, i cili nuk përmbush kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe vijon analizën duke konsideruar si burim krijimi të llogarisë rrjedhëse vetëm kursimet në vite.

19.21. Nga sa përshkruar më lart, rezulton se subjekti, edhe lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar më herët në kohë për krijimin e saj, në DPV-2015, ndërsa duhet ta deklaronte atë në DPV-në e mëpasshme, atë të vitit 2016, si një pasuri e krijuar në këtë vit. Duke marrë nxitje nga shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 21.03.2016, subjekti ka deklaruar në deklaratën e vitit 2015, veprimet financiare të kryera në vitin 2016. Nën këtë optikë, subjekti ka deklaruar edhe veprimin financiar të depozitimit në llogarinë e pagës në BKT, shumën prej 2.000.000 lekë, duke pakësuar *cash*-in me këtë vlerë. Të njëjtin deklarinë ka kryer subjekti edhe në DPV-në e vitit 2016, në të cilën ka zbërthyer vlerën gjendje të kësaj llogarie në fund të vitit 2016, nga të cilat 2.000.000 lekë janë derdhur nga *cash*-i në vite dhe diferenca nga paga e vitit 2016.

19.22. Për sa më sipër, trupi gjykues duke përdorur konkluzionet lidhur me krijimin e depozitës në vitin 2012 dhe tërheqjen e saj në vitin 2014, si edhe në këndvështrim të deklarimeve të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, në të cilën deklaroi se ka pakësuar gjendjen *cash* për krijimin e kësaj llogarie, veprim i potencuar në DPV-2016 dhe procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në mars 2016, arriti në konkluzionin se subjekti ka përdorur për krijimin e kësaj llogarie pikërisht kursimet e akumuluar si më lart, përfshi edhe ato të krijuara gjatë vitit 2015. Në analizë të të dhënave financiare si më sipër, rezultoi se subjekti kishte mundësi të kreditonte në llogarinë bankare në BKT, në datën 23.03.2016, shumën prej 2.000.000 lekësh.

19.23. Trupi gjykues në përfundim të analizës që lidhet me kundërshtitë e subjektit për konkluzionet e Komisionit që lidheshin me pasurinë obligacione dhe llogari rrjedhëse, e gjeti të drejtë vendimin e Komisionit vetëm për sa i përket deklarinë të pasaktë të kredisë si burim për krijimin e tyre, duke u gjendur subjekti në situatën që vjen në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë, në përfundim të analizës së kryer më sipër, trupi gjykues konstatoi se problematikat që duhej të konsideroheshin prej tij për të arritur në një përfundim lidhur me besueshmërinë e subjektit për këtë kriter, janë balanca negative e konstatuar në vitin 2003, në vlerën prej 1.007.790 lekësh, balanca negative në momentin e krijimit të pasurisë *depozitë*, në vitin 2012, në vlerën prej 470.068 lekësh, si edhe pasaktësia në deklaram lidhur me burimet e krijimit të pasurive. Trupi gjykues ka konsideruar disa rrethana, që adresohen veçanërisht në balancën negative prej 1.007.790 lekësh, për krijimin e shumës prej 4.000.000 lekësh, të deklaruar në vitin 2003, si: **(i)** moskonsiderimi për shkak të pamundësisë për të provuar një sërë të ardhurash e interesash të pretenduara në atë kohë, të cilat, objektivisht, duhet të kenë ekzistuar pavarësisht se rezultoi e paprovuar sasia e të ardhurave të krijuara prej tyre; **(ii)** faktin që shuma ka qenë e depozituar në sistemin bankar, duke mos iu fshehur verifikimit të saj; **(iii)** periodha e marrë në analizë për krijimin e saj, e cila është jashtë regjimit të zbatimit të ndonjë legjislacioni që lidhet me deklaramet e pasurisë. Për pasojë, nuk ekzistojnë deklarime periodike që mund të kishin ndihmuar në qartësimin e situatës, por edhe të kishin ndërgjegjësuar subjektin në dokumentin e të ardhurave të saj dhe familjarëve; **(iv)** konsistencën në deklarime, qofshin ato nëpër deklarata periodike, por edhe gjatë hetimit, duke pasur një linjë deklarimi për sa i përket përdorimit të kursimeve në vite si burim për krijimin e pasurisë, e cila vjen në përputhje të plotë me mënyrën se si subjekti duket që e ka krijuar jetën e saj financiare. Rezulton se ajo ka filluar të krijojë kursime, madje në sistemin bankar që në vitin 1986, nëpërmjet kreditimeve të drejtpërdrejta nga paga, edhe për shkak të faktit se ajo ende nuk kishte krijuar familjen e saj, rrethanë që duket se mundësonte pasjen e kësaj lloj sjelljeje me financat personale; **(v)** rrethanat familjare të subjektit, duke qenë se vlera më e lartë e balancës negative në vitin 2003 lidhet me funksionimin e një ekonomie të përbashkët familjare me prindërit dhe vëllezërit, të cilët kryenin aktivitet privat, pa pasur ndonjë detyrim të posaçëm të ngjashëm me subjektin e rivlerësimit, që do të thotë se veprimtarinë e tyre, me ndikim në ekonominë familjare, mund ta zhvillonin edhe në kushtet e informalitetit të lartë të kohës; **(vi)** koha e largët e krijimit të kësaj pasurie edhe mospërsëritja më tej në vite e një situatë të tillë negative.
21. Trupi gjykues vlerësoi se rrethanat e mësipërme, krahas peshës jopërcaktuese të dy rrethanave të tjera që lidhen me pasaktësinë në deklarime, përcaktojnë thirrjen për zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit lidhur me arritjen e nivelit të besueshmërisë për kriterin e pasurisë, në zbatim të nenit 4, pika 5 dhe nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti për shkak të këtyre rrethanave vlerësohet se e kapërcen këtë test, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

22. *Lidhur me cenimin e besimit të publikut*

22.1. Në përfundim, trupi gjykues mori në shqyrtim kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionin e Komisionit, se ajo ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, mbështetur kryesisht në argumentin se ajo ka përfituar një kredi me kushte lehtësuese në shkelje të kriterëve ligjore, si edhe konstatimeve që lidhen me deklaramet e saj të pasakta në vite për përdorimin e kursimeve në *cash*, të cilat kanë krijuar vështirësi për vlerësimin e pasurisë prej Komisionit. Subjekti ka pretenduar në ankim dhe parashtrime se ky konkluzion duhet të kontrollohet nga Kolegji edhe në këndvështrim të rrethanave të dala pas marrjes së vendimit dhe që demonstrojnë integritetin e saj profesional, pra të kundërtën e asaj që ka konkluduar Komisioni.

22.2. Komisioni ka mbështetur konkluzionet e tij për marrjen e një kredie me kushte lehtësuese prej subjektit në shkelje të parashikimeve ligjore, duke kryer veprime që bien ndesh me etikën e magistratit, mbështetur në të dhënat si vijon:

(i) është përfituar në vitin 2011, tërhequr nga subjekti në datën 5.8.2011, kohë kur subjekti ushtronte funksionin e prokurorit në Lushnjë; (ii) pasuria që do të blinte subjekti nuk ndodhej në qytetin e Lushnjës sipas VKM-së, por në qytetin e Tiranës, pra kishte ndryshim destinacioni; (iii) subjekti ka pasur gjendje të likuiditeteve bankare në shumën 5.326.871 lekë, por edhe likuiditete cash sipas deklarimeve vjetore, DPV-ve, fakte të cilat bie ndesh me pikën 6/ç të VKM-së së sipërcituar, ku subjekteve, të përcaktuara në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, u lind e drejta për strehim apo për sipërfaqe shtesë banimi, kur: "... ç) nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/tes pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshirë edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim"; (iv) subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion ligjor kërkesën për transferim në Tiranë të saj dhe të bashkëshortit.

22.3. Subjekti, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, por edhe në ankim, është përpjekur të provojë se vullneti dhe dëshira e saj në kohën e marrjes së kredisë ishte që të kishte mundësi të transferohej në Tiranë, për këtë qëllim do t'i duhej edhe të siguronte banimin në këtë qytet. Sipas subjektit, ky qëllim pothuajse u finalizua në vitin 2013, por ajo nuk ishte më e interesuar për këtë lëvizje në këtë kohë. Gjithashtu, subjekti është përpjekur të arsyetojë në ankim se gjendja e saj financiare e kursimeve në cash dhe në sistemin bankar në kohën e përfitimit të kredisë dhe disbursimit të saj, nuk ishte në vlerën prej 5.000.000 lekë, por më e ulët se kjo vlerë, duke prezantuar një analizë të copëzuar mes momenteve të aplikimit për kredi, miratimit të saj dhe atij të disbursimit të kredisë efektivisht.

22.4. Në ankim, subjekti në funksion të vlerësimit nëse ajo gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, kërkon nga Kolegji të mbahet në konsideratë fakti që, me vendimin nr. {***}, datë 02.10.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me kërkesë të Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve të këtij organi, është vendosur: *"Për miratimin e kërkesës për zgjatje të mbrojtjes së veçantë të Prokurores Merita Selimi"*²⁵.

22.5. Lidhur me kushtet e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, konstatohet se, në VKM-në 600/2007, në pikën 2, si kriter për dhënien e kredisë parashikohet se subjekteve të përcaktuara në këtë vendim, iu lindte e drejta të kërkojnë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që nënkupton territorin e rrethit ku subjekti kryen funksionin apo ushtron detyrën. Në rastin konkret, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, konstaton se pasuria "Apartament", e financuar pjesërisht nga kredia me kushte lehtësuese, e përfituar nga subjekti i rivlerësimit, ndodhet në Tiranë, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit pa ndërprerje ka ushtruar funksionin si prokurore vetëm në rrethin e Lushnjës. Në këto

²⁵ Ky vendim i KLP-së, në përmbajtjen e tij referon si element që ka çuar në dhënien e mbrojtjes së veçantë të prokurores Merita Selimi, deklaratimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë, M. T., lidhur me ndjekjen e saj nga shtetasi L. H. dhe grupi i tij, për shkak të ushtrimit të detyrës, për regjistrimin dhe hetimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2017, për veprat penale të parashikuara nga neni 79/dh, e 25, 278 dhe 274 të Kodit Penal, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 333/a, të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve L. H., O. B. dhe A. K. Mbi bazën e këtyre të dhënave, në zbatim të nenit 20, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, KLP ka vlerësuar se: *"ekziston një rrezik eminent, real dhe i drejtpërdrejt për jetën, shëndetin dhe pasurinë e prokurores Merita Selimi, të përfshirë drejtpërdrejt në çështjet e sipërcituara"*.

kushte, trupi gjykues vlerëson se, me të drejtë, Komisioni ka konstatuar se blerja e apartamentit në Tiranë nga subjekti, e financuar kryesisht me fondet e kredisë së butë, është një situatë faktike, e cila nuk përputhet me përcaktimet e VKM-së 600/2007, për të ezauruar nevojat për strehim të subjekteve kërkues me banesa në territorin e rrethit në të cilin ata ushtronin funksionin.

22.6. Përveç sa më sipër konstatohet se VKM-ja 600/2007, në pikën 6/ç, si kërkesë tjetër për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese, përcakton edhe mospasjen në zotërim të likuiditeteve, në një vlerë më të lartë se vlera maksimale e kredisë, e cila në këtë rast është 5.000.000 lekë. Nga analiza e kryer në Komision rezulton se subjekti, në momentin e pagesës së këstit të parë të apartamentit, më datë 17.12.2010, pretendon se kishte në dispozicion gjendje *cash* dhe likuiditete bankare në vlerën 5.326.871 lekë. Nga verifikimi i kryer në Kolegj lidhur me gjendjen e likuiditeteve të subjektit,²⁶ pas kryerjes së pagesës së këstit të parë të apartamentit, i cili daton në kohë para lidhjes së kontratës për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese, që është nënshkruar më datë 26.02.2011, rezulton se subjekti kishte likuiditete në masën rreth 5.2 milionë lekë, duke tejkaluar në këtë mënyrë kërkesën e VKM-së nr. 600/2007 me rreth 169.000 lekë.

Në këto kushte, trupi gjykues, duke konfirmuar konkluzionet e Komisionit lidhur me përfitimin prej subjektit të një kredie në kushte lehtësuese jo në përmbushje me kriteret e parashikuara prej VKM-së nr. 600/2007, për shkak të blerjes së pasurisë së financuar me këtë kredi jashtë qytetit ku subjekti ushtronte funksionet dhe të faktit që dispononte likuiditete në *cash*, mbi nivelin e parashikuar në këtë vendim, e mori këtë qëndrim në konsideratë të situatës që kjo problematikë mbeti e vetmja e vlefshme, e trajtuar prej Komisionit në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

22.7. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, ndonëse subjekti i rivlerësimit kishte përfituar kredinë me kushte lehtësuese, në kushte që nuk vinin në përputhje me kriteret e përcaktuara nga VKM-ja nr. 600/2007, për sa i përket faktit se subjekti e kishte blerë apartamentin e financuar me kredinë e butë jashtë qytetit ku ushtronte detyrën, si edhe duke disponuar një shumë në gjendje *cash* sa vlera e kredisë që përfitoi, veprimet e saj nuk shoqërohen me rrethana që tregojnë për ndërtimin e ndonjë skeme përfituese apo në deformim të rrethanave faktike. Nga ana tjetër, shkeljet konsistojnë në drejtim të faktit se apartamenti nuk është blerë në qytetin e Lushnjës, por në atë të Tiranës, rrethanë që, ndonëse nuk vjen në përputhje me kriterin e përcaktuar në VKM-në nr. 600/2007, tregon orientimin e subjektit për vijimin e karrierës së saj. Në këtë kontekst, orientimi drejt Tiranës dhe pritshmëria për këtë transferim, nuk duken synime jo realiste dhe të paarsyeshme, duke qenë se dëshira apo shpresa e subjektit për t'u transferuar në një zyrë më të madhe dhe më të rëndësishme, duket e logjikshme në kontekstin e një karriere të gjatë në qytetin e lindjes dhe ndonëse ky fakt nuk ka ndodhur, nuk përjashtohet prezumimi se është pritur prej saj të ndodhë. Analiza lidhur me vendin e investimit kryhet edhe në konsideratë të faktit se ai duket se synon strehimin dhe jo akomodimin në banesa luksi apo për qëllime dëfrimi. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk e ka përdorur këtë kredi për të blerë një apartament të dytë apo për të shtuar pasuri si qëllim në vetvete, duke qenë se, edhe në kohën e shqyrtimit të çështjes në Komision, subjekti rezulton se nuk zotëron një banesë tjetër, as në qytetin e Lushnjës, ku ushtronte funksionet, dhe as në ndonjë qytet tjetër, të krijuar me të ardhurat e saj. Apartamenti në Tiranë rezulton të jetë e vetmja pasuri e paluajtshme e krijuar prej subjektit gjatë gjithë periudhës së punës së saj dhe të personit të lidhur.

²⁶ Në shumën prej 1.169.242 lekësh në llogari bankare, si dhe *cash*-i i deklaruar ndër vite prej 4.000.000 lekësh.

22.8. Për sa i përket zotërimit të shumës prej 5.326.871 lekë, në momentin e miratimit të kredisë, ndonëse kjo rrethanë nuk vjen në përputhje me kriterin e vendosur në VKM-në nr. 600/2007, rezulton se edhe kjo shumë është përdorur për financimin e të njëjtin apartament, i cili është krijuar me burim kredinë dhe shumën e zotëruar prej kursimeve në *cash*. Ky fakt tregon se subjekti nuk e ka përdorur atë për qëllime të tjera, por e ka vënë në shërbim të krijimit të së njëjtës pasuri, si e vetmja e paluajtshme e krijuar prej saj. Gjithashtu, sipas një vlerësimi të çmimeve të tregut në kohën e blerjes së pasurisë, qoftë edhe në referim të të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave (EKB), rezulton se një apartament me sipërfaqe totale 98.25 m² do të kushtonte në një vlerë të pamundur për t'u përballuar me kredinë që ka përfituar subjekti²⁷. Nëse do të arsyetonim se subjekti nuk duhej të kishte në zotërim shumën prej 5.000.000 lekë, si një parakusht për të përfituar kredinë, qëllimi i marrjes së saj do të ishte i pamundur të realizohej, dhe vetë kredia do të humbiste kuptimin e përfitimit. Edhe në rrethanat konkrete, rezulton se subjekti ka shpenzuar vlerën prej rreth 10 milionë lekë për blerjen e tij, që provon se shuma e pasur në zotërim ka shërbyer vetëm për të bërë të përdorshme kredinë e marrë me kushte lehtësuese, përndryshe ajo do të humbiste kuptimin e saj.

22.9. Rrethanat e mësipërme u mbajtën në konsideratë në vlerësimin e peshës që shkelja e kriterëve të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese do të duhet të kishte në matjen e ndjeshmërisë së publikut rreth kësaj sjellje jashtë gjyqësore dhe nëse ajo do të kishte cenuar besimin e tij te sistemi i drejtësisë.

22.10. Çështja tjetër e analizuar prej Komisionit, në kuadër të cenimit të besimit të publikut, ajo që lidhet me pasaktësitë në deklarime apo paqartësinë për destinacionin e përdorimit të likuiditeteve të subjektit, që e kishin pamundësuar Komisionin për vlerësimin e kriterit të pasurisë, jo vetëm morën përgjigje të ndryshme nga analiza e trupit gjykues si më lartpërkthuar, por edhe u vlerësuan të pamjaftueshme në parim për t'u përdorur si një tregues që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, përderisa ato konsistojnë në thelb në pasaktësi të deklarimeve për burimet e krijimit të pasurive.

22.11. Në këto rrethana, trupi gjykues konfirmoi se problematikat e konstatuara në rastin e përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese si të vetme, dhe në kontekstin e rrethanave të analizuara më lart, nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe të thirrej për zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

22.12. Trupi gjykues, ndonëse jo me peshë në zgjidhjen e çështjes, por si një *obiter dictum*, sjell në vëmendje edhe ngjarjet e ndodhura pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, dhe që dëshmojnë për përgjegjshmëri, profesionalizëm dhe integritet në ushtrimin e funksioneve të prokurorit prej subjektit, të cilat nuk mbështesin gjithsesi konkluzionin për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

23. Për sa më lart, në përmbyllje të kësaj analize, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe në konsideratë të

²⁷ Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare në internet të Entit Kombëtar të Banesave, rezulton se nëpërmjet Udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, si çmim mesatar i tregut të lirë të shitblerjes së banesave në Tiranë është identifikuar vlera 88.200 lekë/m². Nëse për apartamentin e subjektit me sipërfaqe totale 98.25 m² do të aplikohet çmimi prej 88.200 lekë/m² rezulton se kjo pasuri do të vlerësohej në shumën 8.665.650 lekë, vlerë e cila shkon ndjeshëm shumë në kredisë së butë të përfituar nga subjekti, prej 5.000.000 lekësh.

Shih: https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_4_23.11.pdf

konkluzioneve të Komisionit për një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, germa “b” dhe “c” të po këtij ligji, vlerëson se vendimi i Komisionit objekt gjykimi duhet të ndryshohet dhe subjekti të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 12.03.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare/anëtare e trupit gjykues, Natasha Mulaj, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, kam votuar kundër vendimit nr. 20, datë 12.03.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për ndryshimin e vendimit nr. 691, datë 27.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi. Qëndrimin tim kundër vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues e mbështes në argumentet e mëposhtme.

Për pasurinë “Apartament banimi”, ndodhur në {}, Tiranë***

2. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*: “[...] Apartament 87.44 m², {***}, Bashkia Tiranë, në vlerën 73.687 euro (konvertuar me lekë, 10.146.699 lekë). Pjesa takuese në bashkëpronësi me bashkëshortin, me burim krijimi: kursimet e 30 viteve punë, si dhe një pjesë të kredisë prej 5 milionë lekë të kredituar nga BKT, me 4% në vitin 2011”.
3. Për herë të parë, pasuria objekt shqyrtimi deklarohet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2010: “Apartament banimi 2+1 {***}, Tiranë (kontratë parablerje shitje, datë 17.12.2010), Burimi – kursimet 22 vjet punë, si dhe një pjesë, 5 milionë kredi bankare në BKT, me 4 % interes, e palëvruar. Vlera: 73.687 euro (paguar 20.000 euro, kësti i parë)”.
4. Sikurse konstatohet nga dokumentacioni i administruar, ky apartament është përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj me kontratë paraprake shitjeje (kreditimi), e cila mban datën 17.12.2010, nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShPK, kundrejt çmimit 73.687 euro. Lidhur me likuidimin e kësaj shumë, në kontratë citohet që kësti i parë, prej 22.000 euro, është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale, ndërsa kësti i dytë, në shumën 51.687 euro, do të likuidohej në momentin që pala blerëse do të përfitonte një kredi bankare nga Banka Kombëtare Tregtare ShA, Tiranë.

I. Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie

5. Për burimin e parë të krijimit të kësaj pasurie, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, kursimet e punës, subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, të vitit 2003: “Gjendje cash, 4.000.000 milionë lekë. Burimi: Kursime nga puna 20-vjeçare”. Me të drejtë, Komisioni verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin kursimeve në shumën e deklaruar më sipër deri në fund të vitit 2003, nga ku rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.163.429 lekë. Edhe pse shumica e trupit gjykues pranoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare si të ardhur të ligjshme, interesin e përfituar nga investimi në shoqërinë “{***}” ShPK, përsëri rezultatet e saj treguan pamjaftueshmëri, balancë negative në vlerën (-) 1.007.790 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

II. Lidhur me pagesën e këstit të parë të apartamentit, në datën 17.12.2010, në shumën 22.000 euro

6. Nga analizimi i deklaratës periodike vjetore 2010, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme/ shtesa dhe pakësime”, pakësimin e gjendjes *cash* si burim për shlyerjen e këstit 22.000 euro për blerjen e

apartamentit, sipas kontratës së sipërcituar. Në kuadër të këtij procesi, ligji i posaçëm nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij, është kujdesur t'u atribuojë cilësinë e provës deklarave periodike vjetore të paraqitura më parë në ILDKPKI, fuqia provuese e të cilave merr një rëndësi të veçantë sa i përket provueshmërisë së shtesës apo pakësimit të gjendjes *cash*, si mjet i vetëm për përcaktimin dhe përdorimin e saktë të tyre. Në vijim, vetë Kolegji, nëpërmjet vendimit nr. 7/2019 (JR), paragrafi 39, në bazë të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka orientuar Komisionin, *të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve "cash" si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.*

7. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mundësi financiare për kursimet e deklaruara në periudhën 2004 – 2009, në kushtet kur, si pasojë e rezultatit negativ deri në fund të vitit 2003, nuk arrihet të justifikohet me burime të ligjshme shuma e deklaruar në këtë vit, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore 2010, me qëllim përdorimin e saj për pagesën e kështit të parë prej 22.000 euro (e konvertuar në 3.053.820 lekë), çmoj të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendimin e tij, që nuk ka marrë në konsideratë përdorimin e këtyre kursimeve si burim financiar për mbulimin e këtij kësti për blerjen e apartamentit, të padeklaruara si të pakësuara sipas ligjit, por të pohuara pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 21.03.2016, gjë e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

III. Lidhur me pagimin e kështit të dytë të apartamentit, në shumën 51.687 euro

8. Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit deklaron: *"Kontratë hipoteke nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 26.02.2011, lëvruar kredia 5 milionë lekë, në 05.08.2011. Paguear 53.687 euro, nga këto 5 milionë lekë kredi. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në këtë deklaratë se shuma 2.117.300 lekë buron nga pakësimi i gjendjes cash të akumuluar në banesë deri në fund të vitit 2010, për të cilin vlen i njëjti arsyetim si në paragrafin më sipër.*
9. Lidhur me shumën 51.687 euro, të marrë nga vëllai, për një periudhë 6 (gjashtë) ditore, pretendim ky i ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë procesit të rivlerësimit dhe për të cilin, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaron: *"Vlera 51.687 euro i është marrë vëllait në mirëbesim, në datën 29.07.2011, por kundërvlehtë në monedhën lekë i është paguar atij disa ditë më pas. Në datën 05.08.2011, unë kam bërë tërheqjen në bankë të vlerës 5.000.000 lekë, shumë të cilën ia kemi dorëzuar vëllait, T. Q., së bashku me vlerën 2.117.300 lekë (ndoshta edhe ndonjë shumë tjetër e vogël sipas kursit të këmbimit), e cila na ishte kthyer cash nga administratori/pronari i shoqërisë, z. H. F., po atë ditë. Pra, vëllait i është paguar/dhënë në ditët e para të muajit gusht të vitit 2011, vlera përkatëse në lekë, si kundërvlehtë e shumës 51.687 euro, e cila na ishte dhënë prej tij për të paguar shumën 51.687 euro, në datën 29.07.2011.*

Në këto kushte, konstatoj të drejtë vlerësimin e Komisionit se: *"Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar/specifikuar marrjen dhe përdorimin e përkohshëm të fondeve prej 51.687 euro nga vëllai i saj, në deklaratën vetting - (si burim i përdorur fillimisht në momentin e pagesës, ndonëse për një periudhë të shkurtër njëjavore) - apo gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, në vitin 2016.*

10. Përpos kësaj, kontradiktat që rezultojnë në kontratat noteriale në dosje, të lidhura rregullisht, që në respektim të nenit 690 të Kodit Civil, kanë forcën e ligjit për palët, më përforcojnë bindjen se

qëndrimet e subjektit të rivlerësimit nuk duken të besueshme, duke mos kapërcyer kështu nivelin deklarativ, pasi nuk gjejnë mbështetje të plotë në dokumentacionin e administruar për këtë pasuri.

Në rastin konkret, ndryshe nga parashikimet në kontratën paraprake të shitjes, të lidhur më datë 17.12.2010, në të cilën përcaktohet se kësti i dytë, në shumën 51.687 euro, do të likuidohet në momentin që pala blerëse do të përfitojë kredi bankare nga BKT ShA Tiranë, vetëm 6 (gjashtë) ditë më pas, të njëjtat palë kontraktore, pala *shitëse*, shoqëria “{***}” ShPK dhe pala *blerëse*, Merita e A. Selimi, kanë nënshkruar një kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., në datën 23.12.2010, në të cilën parashikojnë se vlera 73.687 euro, e konvertuar në 10.146.699 lekë, *është likuiduar nga ana e blerësve* në favor të shitësit, jashtë zyrës noteriale.

11. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shumën e huazuar nga vëllezërit (për këstin e dytë të apartamentit), është i jo i besueshëm dhe duket se është përdorur si mjet për të justifikuar ligjshmërinë e pagesës së këstit të dytë për blerjen e tij. Nga ana tjetër, më duket i paqartë dhe aspak bindës pretendimi se shoqëria e kërkonte shumën në monedhën *euro*, në një kohë që në kontratën përfundimtare të shitjes, së datës 23.12.2010, si dhe në deklaratën noteriale të së njëjtës datë, përveç çmimit në euro, përcaktohet edhe ekuivalenti në lekë, gjë që prezumon lejimin/shlyerjen e pagesës në të dyja monedhat të paracaktuara në kontrata.
12. Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në vitin 2003, për shlyerjen e këstit të parë dhe të dytë të pasurisë “Apartament”, të ndodhur në {***}, Tiranë, duke u kualifikuar në kushtet e parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në atë nivel sa e bën të zbatueshëm aplikimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

IV. Lidhur me kredinë bankare me kushte lehtësuese nga shteti, në shumën 5 milionë lekë

13. Si gjyqtare në pakicë, jam shprehur kundër qëndrimit të shumicës edhe për sa i përket përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese nga subjekti i rivlerësimit, pasi edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, mbeti e provuar se blerja e apartamentit në Tiranë nga subjekti, e financuar kryesisht me fondet e kredisë së butë, është një situatë faktike, e cila nuk përputhet me përcaktimet e VKM-së nr. 600/2007, për të ezauruar nevojat financiare të kërkuesve në drejtim të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, në territorin e rrethit në të cilin ata ushtrojnë funksionin. Nga verifikimi i kryer në Kolegj, lidhur me gjendjen e likuiditeteve të subjektit, pas kryerjes së pagesës së këstit të parë të apartamentit, i cili daton në kohë para lidhjes së kontratës për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese, rezultoi se subjekti kishte likuiditete të mjaftueshme, duke tejkaluar në këtë mënyrë kërkesën e pikës 6/ç të VKM-së nr. 600/2007.
14. Në këto kushte, çmoj se përfitimi nga ana e subjektit të një kredie me kushte lehtësuese, duke e përdorur si mundësi investimi për blerjen e një pasurie në Tiranë, jashtë territorit të rrethit në të cilin ushtrohet funksioni i prokurorit prej saj, me pretendimin e orientimit të karrierës së subjektit drejt Tiranës dhe pritshmërive për këtë transferim, si dhe me qëllim arsimimin e vajzës së tyre në Tiranë, janë qartazi në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësist dhe kriteret përcaktuese të VKM-së nr. 600/2007, të cilat lidhen thelbësisht me elementet kyçe të qëllimit të ndihmës nga ana e buxhetit të shtetit, për përfitimin e mundësisë për strehim në vendin e punës, ku ndodhet selia administrative e organit ku një funksionar ushtron detyrën dhe me pamundësi financiare nga ana e funksionarit publik, dhe bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror në raport me respektimin e kërkesave të ligjit.

15. Për sa më sipër, problematikat në vlerësimin e kriterit të pasurisë, mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, për gjendjen *cash*, për burimin e krijimit të pasurisë dhe mënyrën e përfitimit të saj, balanca negative para vitit 2003 dhe para lidhjes së kontratës paraprake në vitin 2010, për pagimin e kështit të parë dhe të dytë, si dhe përfitimi i kredisë bankare jashtë kriterëve ligjore dhe pas lidhjes së kontratës së shitjes mes palëve, si dhe paqartësia për destinacionin e saj, për mua, si gjyqtare në pakicë, çmohen të mjaftueshme për të vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke zbatuar për rrjedhojë nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
16. Në mbështetje të arsytimit më sipër, si dhe në kuptim të përcaktimeve të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet si më poshtë: *a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.* Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, nuk plotësohen kushtet e mësipërme, pasi përveç problematikave thelbësore për kriterin e vlerësimit të pasurisë, DSIK, në raportin e saj të datës 29.08.2022, ka referuar se subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës në të cilën ushtronte detyrën e prokurores, dyshohet së është përfshirë në veprime korruptive, për përfshirje në veprime të kundërligjshme, gjatë hetimit të disa çështjeve penale, për pasojë, lidhur me kriterin e figurës së subjektit të rivlerësimit, e ka cilësuar *të papërshtatshme për vazhdimin e detyrës.*
17. Në mbështetje të vendimit të Komisionit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, në kuptim edhe të nenit 61, pika 5, dhe nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për mua, si gjyqtare në pakicë, nuk plotëson kushtet për konfirmim në detyrë, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “a” të po këtij ligji, vendimi nr. 691, datë 27.07.2023, i Komisionit, duhet të lihet në fuqi.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi